



# **Analiza Financiare e Vitit 2016**

**dhe**

# **Plan Buxheti i Vitit 2017, 2018, 2019**



## PERMBAJTJA

### KAPITULLI I

1. MISIONI I BASHKISE BERAT
2. MESAZHI I KRYETARIT TË BASHKISË BERAT PËR BUXHETIN E VITIT 2017
3. PROFILI I BASHKISË BERAT

### KAPITULLI II

#### ANALIZA E REALIZIMIT TE TREGUESVE TE BUXHETIT TE VITIT 2016

- A. Informacion i pergjithshem mbi realizimin e buxhetit.....
- B. Zhvillimet Fiskale gjate vitit 2016.....
- C. Plani Financiar I Bashkise Berat dhe Struktura financiare buxhetore e vitit 2016
- D. Analiza e realizimit te planit te te ardhurave.....
- E. Analiza e realizimit te planit te shpenzimeve korrente.....
- F. Investimet publike .....
- G. Auditimi- .....

### KAPITULLI III

#### PLAN BUXHETI 2017-2018-2019

1. Informacion i permblodhur plan buxhetit te vitit 2017.....  
Struktura financiare buxhetore e vitit 2017 .....
2. Te ardhurat e pushtetit lokal .....
- 2.1 Te ardhurat lokale..2017-2019.....
- 2.2 Transferta e Pakushtëzuar nga Buxheti i Shtetit.....
- 2.3 Transferta të Kushtëzuara nga Buxheti i Shtetit.....
- 2.4 Fondet për zhvillimin e rajoneve.....
3. Plani i shpenzimeve.....
- 3.1 Plani i shpenzimeve sipas programeve buxhetore.....
- 3.2 Perdorimi i teprices neto operateracionele per investime.....
- 3.3 Alokimi I fondeve sipas programeve.....



*KAPITULLI I*

**MISIONI I BASHKISE BERAT**

*Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet:*

- a) njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive;*
- b) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera;*
- c) zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë;*
- ç) ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore;*
- d) realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë;*
- dh) nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;*
- e) realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera*



## KAPITULLI I

### 1. MESAZHI I KRYETARIT TË BASHKISË BERAT PËR BUXHETIN E VITIT 2017

E nderuar Kryetare e Këshillit, Znj. Nikoleta Manka!

Të nderuar këshilltarë të Bashkisë Berat!

Të dashur bashkeqytetarët e mi!

Në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë, përcjell tek të gjithë ju të zgjedhurit dhe vendimarrësit e Këshillit Bashkiak, tek bashëkpuntorët e stafit, tek grupet e interesit, tek partnerët dhe tek i gjithë komuniteti i Bashkisë sonë të re, mirënjohje dhe vlerësim për arritjet që kemi shënuar gjatë vitit 2016, për sfidat që sëbashku kemi përballuar, për përmbushjen e misionit të Qeverisjes Vendore, në funksionet që na ngarkon ligji dhe në realizimin e buxhetit të vitit 2016 që po mbyllim.

Në këndvështrimin tim, përtej shifrave dhe statistikave, do të nënvizoj risitë dhe ndryshimet që u reflektuan gjatë vitit 2016.

#### **Së pari: Buxheti i vitit 2016 ishte një buxhet i përballjes me sfidat:**

- Viti 2016, shënon një tjetër moment historik të decentralizimit dhe të autonomisë së pushtetit vendor, në zbatim të Ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen Administrativo - Territoriale të Njërive të Qeverisjes Vendore në Shqipëri“, bazuar në Ligjin “Për vetëqeverisjen vendore”, 139/2015 i cili hyri në fuqi në 1 janar 2016, filluan funksionimin 61 Njësitë e Qeverisjes Vendore, pra Bashki.
- Bashkive iu transferuan funksione të reja dhe u financuan nëpërmjet **transfertave specifike për çdo funksion dhe për çdo njësi**. Në Ligjin “Për vetëqeverisjen vendore”, nr.139/2015, është parashikuar një dispozitë tranzitore, e cila sanksionon se funksionet e reja do të financohen nga qeveria qendrore me transferta specifike për çdo funksion dhe çdo njësi përfituese të fondeve.
- **Fondi për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2016**, skemë e suksesshme në financimin e programeve në tri shtylla kryesore:
  - A.** Programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale vendore.
  - B.** Programi i mbështetjes së ekonomisë.
  - C.** Programi Shqipëria dixhitale

Bashkia Berat, në të tre shtyllat, ka aplikuar dhe ka thithur projekte tek FZSHH-ja dhe FZHR-ja.

- Detyrimi i Bashkive për të përdorur jo më pak se **40% të transfertës së pakushtëzuar për investime**.
  - Buxheti i vitit 2016 mbështetet në një **paketë fiskale** që vlerëson rritjen e të ardhurave lokale **38%** më shumë se pritshmëria e vitit 2015.



## BASHKIA BERAT

Në total, për vitin 2016, të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore janë planifikuar në **shumën 330 milionë lekë**, ose rreth 35 %, kundrejt realizimit të 2015-ës.

Pritshmëria e realizimit të të ardhurave në vitin 2016 shkon në masën 87%.

### Së dyti: **Buxheti i vitit 2016 ishte buxhet që mbështet shërbimet publike:**

Me buxhetin e vitit 2016 u synua dhe u realizua:

1. Shtritja e shërbimeve publike të pastrimit, mirëmbajtjes së varrezave publike dhe të deshmoreve, mirëmbajtjen e lapidarëve , dekorin festiv edhe në njësitë administrative, pjesë përbërëse të bashkisë së re Berat, si dhe kryerjen e këtyre shërbimeve në zbatim të Ligjit për Prokurimin Publik, kontraktim me palë të treta.
2. Kostoja e shërbimit të pastimit në qytet (54.5 milionë lekë ) dhe në njësitë administrative (rreth 6 milionë për vitin 2016), nuk mbulohen nga tarifat përkatëse( si 11- mujour është arkëtuar nga kjo tarifë rreth **55.5** milionë lekë).
3. Mirëmbajtjen e vazhdueshme të rrugëve kryesore, trotuareve, segmenteve rrugore, rehabilitimin e kalldrëmeve , mirëmbajtjen e sistemit të ndriçimit, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve për komunitetin në bashkinë Berat, përfshi Lagjet nr. 1, nr. 2, nr. 3, si dhe në njësitë administrative Roshnik , Otlak , Velabisht , Sinjë.
4. Kostoja e shërbimit të ndiçimit, nuk mbulohet nga tarifa përkatëse e ndiçimit (si 11- mujour është arkëtuar nga kjo tarifë rreth 27.6 milionë lekë).
5. Mirëmbajtjen e sipërfaqeve ekzistuese të gjelbërta, përmirësimin cilësor të tyre.
6. Kostoja e këtij shërbimi nuk mbulohet nga tarifa përkatëse e gjelbërimit,( si 11- mujour është arkëtuar nga kjo tarifë rreth 10.6 milionë lekë).
7. Rritjen e sipërfaqeve të gjelbërta midis blloqeve të pallateve dhe kthimin e tyre në vende atraktive për çlodhje.
8. Rehabilitimi i rrejtës kullues dhe vaditës në territorin e bashkisë Berat si dhe bashkërendimi i punës me institucionet qendrore.

### Së treti: **Buxheti i vitit 2016 ishte buxhet që mbështeti veprimtaritë sociale, kulturore dhe sportive:**

1. Gjatë vitit 2016 u bë identifikimi dhe adresimi i nevojave për ndërhyrje rehabilituese të kopshteve, shkollave 9-vjeçare dhe të mesme në njësitë administrative të bashkisë Berat.
2. U mbështet financiarisht kostoja e funksionimit të Drejtorisë Arsimore të bashkisë Berat, në gjithë komponentët e saj, elementin paga, sigurime shoqërore dhe shpenzime operative të mirëmbajtjes.
3. Kostoja e funksionimit të dy qendrave sociale për PAK-në, kostoja e funksionimit të çerdheve publike, implementim i një sërë bashkëpunimesh me organizma dhe shoqata në projekte të përbashkëta, janë argumente reale për të **cilësuar një buxhet social**.
4. Kostoja e funksionimit të Qendrës Kulturore “Margarita Tutulani”, përfshi Bibliotekën “V.Buharaja”, Galerinë e Arteve “E.Lear”, vërtetojnë më së miri mbështetjen që i jep Bashkia **zhvillimit të kulturës**.
5. Mbështetja financiare me rreth **100% të buxhetit të planifikuar** për Futboll Klub “Tomori 1923 SH.A”, financimi i Klubit Shumësportësh “Tomori”, janë të tjerë argumenta që vërtetojnë se Bashkia mbështet financiarisht **zhvillimin e sporteve**.



## BASHKIA BERAT

6. Bashkia Berat, në vitin 2014, fillon shlyerjen e **kredisë CEB** për ndërtimin e banesave sociale të dhëna me qira. Shlyerja vijoi rregullisht sipas kësteve të përcaktuara nga Ministria e Financave edhe për vitet 2015 e 2016, dhe do të vazhdojë edhe në vitet në vijim. Shlyerja e kështit të kredisë për vitet 2017, 2018, 2019, do të jetë për cdo vit në vlerën **58,770 €**, nga të cilat, **31,770 €** do të shlyhen nga fondet e Bashkisë dhe **27,000 €** do të shlyhen nga fondi i banesave sociale.
7. Bashkia Berat, ka mbështetur financiarisht me bonus strehimi (familje të strehuara në banesat sociale me qira), familjet në nevojë në shumën 1 126 000 lekë, për vitin 2016, Vendimuar kjo në Këshillin Bashkiak., mbështetje e cila do të vazhdojë dhe në vitet në vijim.

**Së katërti: Bashkia Berat mbështetet financiarisht me fonde nga skema e financimit “Fondi për Zhvillimin e Rajoneve”, në objektet e mëposhtëshënuara:**

1. Rivitalizimi i Shëtitores Republika dhe sheshit “Teodor Muzaka”, Loti 3
2. Rikonstruksion i trotuarit, pamakëve dhe ndiçimit në segmentin Ura e varur –Ura e Goricës
3. Rikualifikim dhe rikonstruksion i Parkut Dëshmorët e Kombit
4. Rikonstruksion i Bibliotekës “Vexhi Buharaja”
5. Rikonstruksion i rrugës Stadiumi i Vjetër - Stadiumi i Ri dhe sheshi para stadiumit
6. Rikonstruksion i rrugës “Antipatrea”, Segmenti Ura e Varur - Ura e Goricës
7. Smart Siti, Kjoskat informuese për programin “Shqipëria Digitale”.

**Së pesti: Bashkëpunimi me Organizata dhe Partnerë Ndërkombëtarë**

Bashkia Berat ka punuar intensivisht për gjetjen e burimeve alternative të financimit të projekteve të saj. Është punuar për të aplikuar për çdo thirrje për projekte nga partnerët e huaj dhe do të vazhdojmë me intensitet kontaktet dhe bashkëpunimin me :

- Bashkitë Binjake
- Rrjetet Ndërkombëtare
- Organizatat dhe donatorë
- Projektet e Bashkimit European.

Gjatë vitit 2016 janë realizuar bashkëpunime me Partnerë Ndërkombëtarë për disa projekte të rëndësishme :

- **Banka Botërore**, për financimin e Projektit të Zhvillimit të Turizmit për Shqipërinë e Jugut, pas ratifikimit të Marrëveshjes në Parlamentin Shqiptar, pritet të fillojë në Qershor 2017 dy investime të rëndësishme në qytet:
  - 1- Rehabilitimi i rrugës automobilistike “Muzak Topia” për në Kala.
  - 2- Rehabilitimi i rrugës me kalldrëm për këmbësoret “Mihal Komneno” për në Kala.



## BASHKIA BERAT

- Me **Kooperacionin Zvicerian** është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit për projektin “Menaxhimi i integruar i mbetjeve urbane në Rajonin e Beratit”, projekt i cili do të shtrihet në një periudhë kohore 5- vjeçare dhe do të bëjë të mundur studimin për menaxhimin e mbetjeve në gjithë territorin e Rajonit të Beratit dhe ngritjen e një landfilli, i cili do të përpunojë mbetjet e diferencuara .
- Vazhdon intensivisht puna për rehabilitimin e rrjetit ujësjellës - kanalizime, nëpërmjet kredisë së **Bankës Gjermane KFW**, investim i cili do të zgjidhë brenda vitit 2017 furnizimin me ujë të qytetit të Beratit.
- Me **Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim**, u realizua investimi i rrugës “Naim Frashëri” pranë Sheshit Teodor Muzaka duke mbyllur ciklin e investimeve në Pedonalen e Qytetit
- Në vitin 2017 do të vijojë bashkëpunimi i ngushtë për investime në Qendrën Historike dhe mbështetja për Zonën e Biznesit BID.
- Prezenca e Agjensisë Amerikane për Zhvillim **USAID**, ka qenë prezente në fushën e financave, taksave dhe shërbimet publike për ngritje kapacitetesh dhe logjistike për stafin e bashkisë. Në vitin 2017, do të vijojë puna në këta sektorë, duke qenë bashki e përzgjedhur ndër 5 bashkitë pilot të USAID në Shqipëri.
- Me Organizatën Hollandeze **MatraCoprol**, është bërë i mundur **Projekti i Zyrës me një Ndalesë** për Qytetarët, e cila do të ofrojë shërbime inovative në kërkesë –aneksat dhe aplikimet që do kenë në adresë të bashkisë. Zyra me një Ndalesë do të jetë e pozicionuar në një ambient të bollshëm pranë bashkisë së re, ku sportelet e shërbimit do të ofrojnë një performancë bashkëkohore në pritjen dhe ofrimin e shërbimit ndaj qytetarit.
- Bashkia Berat, në bashkëpunim me **Organizatën Franceze të Qyteteve të Artit dhe Historisë**, kanë filluar punën për Projektin “Zhvillim i Qëndrueshëm në Lagjen Goricë”. Projekti synon asistencë teknike të ekspertëve Francezë në restaurimin dhe rijetezimin e Lagjes Goricë, me funksion zhvillimin e turizmit kulturor.
- Në bashkëpunim me Organizatën Adriopolis, është aplikuar në kuadër të thirrjes së **Borxhit Italian** me projektin për vënien në punë të tregut të agrobiznesit në Moravë, në shërbim të fermerëve, dhe ngritjen e Qendrës së Trashëgimisë Kulturore në ish-shkollën e Kalasë.
- Vazhdon projekti në bashkëpunim me Organizatën e Kombeve të Bashkuara **PNUD**, për integrimin social të popullatës romë në qytetin e Beratit dhe mbështetja për Qendrën Komunitare Rome.
- Në bashkëpunim me Kompaninë Franceze **SICALA**, është krijuar shtegu turistik i Kalasë së Goricës. Përgjatë shtegut të kalasë së Goricës, janë vendosur panele me informacione në dy gjuhë si dhe stola dhe kosha mbeturinash për një eksperiencë sa më të kënaqshme.
- Në bashkëpunim me organizatën **Risi Albania dhe AADF**, u bë e mundur ngritja e **Zyrës së Interpretimit Turistik**, vendosur në qendër të qytetit, ku ofrohen shërbime inovatore për vizitorët.
- Organizata Cesvi, dhe bashkia Berat, kanë aplikuar për një tjetër projekt për turizmin dhe trashëgiminë në qytet. Fokusi i projektit është turizmi rural dhe kulturor, gastronomia si dhe artizanati. Faza e parë e projektit është miratuar dhe pritet vendimi në fazën e dytë në fillim të vitit 2017.
- Gjatë vitit 2016, bashkia Berat, ka aplikuar me 11 projekte në fushën e trashëgimisë, turizmit dhe agrobiznesit, në kuadër të Thirrjeve të **Bashkimit Evropian**, (brenda Janarit 2017 pritet përgjigja e parë mbi këto projekte të aplikuara), të cilat përfshijnë :



- a- Programi *Adrion*
- b- Programi Ndërkufitar Shqipëri- Greqi
- c- Programi i Mesdheut
- d- Programi Interreg Ballkan

### PLAN - BUXHETI I VITIT 2017.

Buxheti i Pushtetit Vendor i vitit 2017, do të jetë 3.1% e PBB-së, duke mbështetur zbatimin e Reformës Administrative Territoriale.

**Transferta e pakushtëzuar do të jetë rreth 20 % më e lartë se e vitit 2016**, dhe do të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e investimeve dhe shërbimeve publike në favor të qytetarëve. Në buxhetin e vitit 2017, një mbështetje të konsiderueshme, gjejnë funksionet e transferuara në vitin 2016.

#### Ndryshimet e taksave në paketën fiskale 2017 në nivel makro:

- Rritet akciza për gazin e lëngshëm
- Hiqet rimbursimi i akcizës për peshkimin
- Dyfishohet akciza për purot, ulet për duhanin vendas
- Renta, ndryshon baza e referencave.
- Taksa për makinat e luksit
- Lehtësirat e paketës fiskale.

Përfitimi më i madh i qytetarëve nga paketa fiskale 2017, pritet të jetë në rimbursimin e barnave.

#### Paketa fiskale e miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 107, datë 25.11.2016 parashikon:

- Lehtësirat tatimore për biznesin dhe konkretisht:
  - Për Bizneset e hapura, nga familjet e reja, dhe të drejtuara nga gra, në vitin e parë të ushtrimit të aktivitetit, për të gjitha Njësitë Administrative, kjo tarifë do të paguhet në **masën 20%** më ulët të tarifës normale.
  - Për familjet me një prind, me fëmijë deri në moshën 22 vjeç, që janë në vazhdimësi të arsimimit, për të gjitha Njësitë Administrativ, kjo tarifë do të paguhet në **masën 30%** më ulët të tarifës normale.
- U ndryshua Tarifa e Pastrimit dhe largimit të mbeturinave **për subjektet e biznesit të madh që nxjerrin gurin ranor**, etj., dhe përpunimin e tyre, për çdo njësi administrative, 80 000 lekë, që do të sjellë ndryshim në të ardhura.
- U shtua **Tarifa e shërbimit për kryerjen e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme**, të ndërtuara deri më 10.08.1991, e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedon akte fitimi pronësie, si dhe për regjistrimin e tyre .
- **Për familjet në nevojë, tarifa e shërbimit** për kryerjen e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.08.1991, e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedon akte fitimi pronësie, do të paguhet në masën **50%** më pak se tarifa normale.

**PLAN BUXHETI 2017:** Finalizohet pas përfundimit të dëgjësave publike sipas Kalendarit Buxhetor të miratuar, të zhvilluara në të gjitha lagjet dhe Njësitë Administrative të Bashkisë Berat.

Problematikat kryesore që u evidentuan në Njësitë Administrative ishin :



## BASHKIA BERAT

- Kanalizimet e ujrave të zeza dhe të ujit të pijshëm.
- Problematika të karakterit infrastrukturor si rrugë, kopshte, argjinaturë mbrojtëse nga lumi Osum, rrugë nëpër parcelat e tokave, ndriçim, sinjalistikë rrugore, bllokimi i kanaleve kullues, mungesa e urave lidhëse
- Shtrirja e shërbimit të pastrimit dhe plotesimi me kontenier të mbledhjes së mbeturinave.
- Kryerja e shërbimit të pastrimit edhe ditën e dielë.

Problematikat kryesore që u evidentuan në Lagjet e Qytetit:

- Gjelbërimi,
- Ambjentet argëtuese për fëmijët
- Ndriçimi gjithashtu, ishin problematika të ngritura nga komuniteti.
- Shërbimi i pastrimit, sidomos në zonën muzeale, problematikat kryesore në Lagjen nr 2.
- Kryerja e shërbimit të pastrimit edhe ditën e dielë në gjithë qytetin.

**PLAN BUXHETI 2017:** Bashkia Berat planifikon për vitin 2017, një buxhet prej 907.8 milionë lekë të cilat përbëhen:

1. Transferta e pakushtëzuar	255.5 milionë lekë
2. Transferta specifike për funksionet e deleguara	221.9 milionë lekë
3. Të ardhurat lokale planifikuar për vitin 2017	430.4 milionë lekë

- ❖ Parashikon rritjen e pagave për gjithë punonjësit e bashkisë.
- ❖ Parashikon përmbushjen e funksioneve të percaktuara në ligjin 139/2015.
- ❖ Parashikohen fonde për parandalimin dhe përballimin e **emergjencave civile**, duke përfshirë ndërhyrjet parandaluese dhe rehabilituese në objektet infrastrukturore si dhe dëmshpërblimin e familjeve, banesat e të cilave janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme. Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr. 8756, datë 26.03.2001 “Për Emergjencat Civile” të ndryshuar, të nenit 29 të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të pikeës III/3 të VKM- së nr.329, datë 16.05.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”.
- ❖ Parashikon mbulimin e **detyrimeve fiskale të Tregut Fruta-Perimeve sh.a. Moravë**. Me Vendimin Nr. 336, datë 4.5.2016, Këshilli i Ministrave ka vendosur transferimin e plotë të aksioneve të shoqërive shtetërore të tregjeve të shitjes me shumicë dhe pakicë të fruta-perimeve në pronësi të njësisë të vetëqeverisjes vendore, një ndër të cilët është edhe Tregu i Shitjes me Shumicë, fruta-perime Morave, Berat, për rrjedhojë dhe të drejtat dhe detyrimet pasurore të tij.

**Në fushën e investimeve publike:** Bashkia disponon projekte për objektet e mëposhtme:

- Rikonstruksioni i Kopshtit 2+3 Barrikadë
- Rikonstruksion Shkolla 9-vjeçare Uznovë
- Rikonstruksion çerdhe, lagja “Donika Kastrioti”
- Rikonstruksioni i Rrugës “Santa Luçia”



## BASHKIA BERAT

- Rikonstruksioni i Rrugës “Gaçi Gjika”
- Rikonstruksioni i trotuarit, parmacëve dhe ndriçimit ne segmentin Ura e Varur – Ura e Goricës
- Rehabilitimi i hapësirave Urbane lagja “30 Vjetori” (rrugët e brendshme te ish pjeshkores)
- Ndërtim I KUZ-së Drobonik
- Ndertimi I KUZ-së Lapardha
- Rikonstruksioni i Kanalit vaditës Sinjë
- Ura Beli-Malinat
- Kopshti në lagjen Barrikadë
- Ndërtim i rrjetit të kanalizimeve në lagjen “Murat Çelebiu”, Rruga “Goshi”.

Nga projektet e mësipërme kanë gjetur zbatim nëpërmjet financimit: Rikonstruksioni i Trotuarit, parmacëve dhe ndriçimit në segmentin Ura e Varur – Ura e Goricës (FZHR), dhe Rehabilitimi i hapësirave Urbane lagja “30 Vjetori” (rrugët e brendshme të ish- pjeshkores), mbështetur financiarisht me fonde te Bashkisë.

Detyra projektimi :

- Segmenti Xhamia e Beqarëve-Axhensi
- Fasadat nga hyrja e qytetit deri në Uznovë
- Rruga Santa Luçia- Ura e Zagores ,Uznovë.

Projekte te hartuara jashtë Bashkisë për objektet :

- Rruga Mihal Komneno – Sheshi Tabia
- Rruga Muzak Topia
- Sheshi Harmonia Fetare.
- Projekti Loti 4 (Lulishte përpara Bibliotekës “V.Buharaja”
- Rikonstuksioni i murit mbajtës të shkollës “22 Tetori”
- Projekti këndi i lojrave të Info Point
- Qendra Argëtuese për fëmijë , pranë Stadiumit të Vjetër.

Bashkia Berat bën aplikime pranë FZHR-së sa herë ka thirje për aplikime nga FZHR-ja. **Projekte në zbatim që kanë filluar në vitin 2016 e vazhdojnë në vitin 2017, që do të financohen me të ardhurat e bashkisë janë;**

- Rikonstruksioni i rrugës Stadiumi i Vjetër – Stadiumi i ri (Shtesë).
- Rikonstruksioni i rrugëve të brendshme të lagjes “30 Vjetori” (Zona Ish Pjeshkorja)
- Ujësjiellës Prokopi - Paftal
- Ujësjiellës Bilçë



- Rikonstrukcioni i godinës së bashkisë së re
- Etj., që do të trajtohen në kapitullin përkatës.

### **Të nderuar këshilltarë !**

**Duke permbushur detyrimin ligjor të paraqitjes së Plan - Buxhetit të vitit 2017, me tregues të dy viteve pasues 2018-2019, si dhe mbështetur ne realizimin faktik të vitit 2015 e pritshmërinë e vitit 2016, kam bindjen se ky material do të gjejë mirëkuptimin Tuaj!**

Analiza ekonomiko-financiare e Bashkisë, në kuadër edhe të diskutimit të Plan-Buxhetit, bazohet në sistemin raportues të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe do të japë një informacion të plotë në kapitujt pasues, mbi realizimin analitik të planit të të ardhurave, realizimit të objektivave, produkteve të çdo programi buxhetor, menaxhimin e investimeve e shërbimeve publike, në shërbimin ndaj komunitetit.

Ju ftoj ta diskutojmë, analizojmë e ta mbështesni këtë Projekt - Buxhet, për te bërë të mundur realizimin e objektivave dhe prioritetve, si një detyrim i përbashkët dhe për t'i ofruar shërbim cilësor çdo qytetari në çdo skaj të Bashkisë Berat!

Sfidë për ne, për administratën e Bashkisë, mbetet realizimi i treguesve të këtij buxheti. Sfida është e vështirë dhe kemi përballje të përditshme me problematika të shumta. Ne do të angazhohemi nëpërmjet rritjes së efikasitetit të punës, menaxhimit të përgjegjshëm të çdo aseti dhe burimi financiar që na jep ligji, kontrolli të rreptë të buxhetit për çdo njësi shpenzuese dhe çdo elementi të shpenzimeve, rritjes së efikasitetit të auditimit të brendshëm.

Më lejoni t'ju uroj Gëzuar Krishtlindjet dhe një Vit të Ri më të mbarë dhe më të suksesshëm për ju, familjet tuaja, por edhe për gjithë komunitetin tonë!

Duke ju uruar punë të mbarë zhvillimit të mbledhjes së sotme, Ju shpreh mirënjohje për mbështetjen që na keni dhënë dhe na jepni në vijimësi!

Faleminderit!

Me respekt,

Petrit SINAJ

KRYETAR I BASHKISE



## BASHKIA BERAT

### KAPITULLI I

#### PROFILI I BASHKISE BERAT

Bashkia e Beratit shtrihet në Krahinën Malore të Shqipërisë Jugore dhe pjesërisht në Ultësirën Perëndimore në të dy anët e rrjedhës së mesme dhe të poshtme të lumit Osum. I cili kalon përmes qytetit të Beratit.

Shtirja në këto dy krahina të ndryshme fiziko-geografike, ndikon në ndryshueshmërinë e relievit të territorit, të kushteve fizikogjeografike nga perëndimi në lindje e nga veriu në jug, e të peisazheve gjeografike.

Me ndarjen e re administrative, Bashkia Berat, përfshin brenda juridiksionit të saj administrativ, qytetin e Beratit, njësitë Roshnik, Otlak, Velabisht dhe Sinjë.

Sipërfaqja e Bashkisë Berat është 380 km<sup>2</sup>, nga 22.4 km<sup>2</sup> që ishte para Reformës Administrative Territoriale 2014. Ndryshimi i kufirit territorial është sfidë për bashkinë në zhvillimin e mëtejshëm.

**Tabela 1. Ndarja administrative e Bashkisë Berat**

Bashkia	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Sipërfaqja (km <sup>2</sup> )	Fshatrat/Qytetet në përbërje të tyre
Berat	Qyteti Berat	Berat	19 km <sup>2</sup>	Qyteti Berat
		Otlak	52.7 km <sup>2</sup>	Lapardha 1, Lapardha 2, Qereshnik, Balibardhë, Dyshtnik, Moravë, Ullinjas, Vodëz e sipërme, Orizaj, Otlak.
		Velabisht	93.2 km <sup>2</sup>	Malinat, Bilçë, Drobonik, Bardhaj i Ri, Starovë, Veterrik, Remanicë, Gjoroven, Palikësht, Veleshnjë, Duhanas, Kodras, Velabisht.
		Sinjë	138.5 km <sup>2</sup>	Mbolan, Mjeshovë, Mbreshtan, Galinë, Sadovicë, Pafтал, Kamçisht, Levan, Velçan, Osmenez 1, Osmenez 2, Plashnik i Vogël, Molisht, Sinjë.
		Roshnik	78.7 km <sup>2</sup>	Bogdan i Poshtëm, Bogdan i Sipërm, Dardhë, Karkanjoz, Kostren i Madh, Kostren i Vogël, Mimias, Perisnak, Qafë Dardhë, Vojnik, Rabjak, Roshnik Qendër, Roshnik i Vogël.



## BASHKIA BERAT

Berati njihet për arkitekturën, vlerat historike, kulturore, artistike dhe fetare. Është qendër ndërkombëtare e trashëgimisë kulturore (lagjet tradicionale të Mangalemit, Goricës dhe kalasë, Muzeu Kombëtar i Ikonografisë “Onufri” dhe galeritë tjera, muze, kishat, xhamitë). Historia 2400 vjeçare e bën atë ndër qytetet më të vjetër të vendit tonë. I shpallur “Qytet Muze” në vitin 1961 dhe aktualisht pjesë e listës të UNESCO-s si një qytet i Trashëgimisë Kulturore Botërore. Në skajin lindor të territorit të saj, bashkia ka një pjesë të Parkut Kombëtar të Tomorrit (2,416m), ndërsa në perëndim përfshin Malin e Shpiragut (1,218m).

Sektorët kryesorë mbi të cilët mbështetet ekonomia e Bashkisë Berat janë bujqësia dhe turizmi. Vlerat e spikatura turistike të cilat lidhen me qytetin muze 2,400 vjeçar të Beratit, parkun kombëtar të Tomorit dhe mjedise të tjera natyrore me florë dhe faunë shumë të pasur janë kthyer në mundësi punësimi dhe zhvillimi ekonomik për Beratin. Ekonomia e qytetit të Beratit mbështet në shërbime.

Njësitë Otlak, Roshnik, Velabisht dhe Sinjë kanë ruajtur karakterin rural. Sektori kryesor i ekonomisë në këto njësi është bujqësia. Kultivimi i pemëve frutore, ullinjve dhe vreshtarisë është parësor në këto zona. Gjithashtu dhe blegtoaria dhe përpunimi i produkteve të mishit dhe qumshut janë të zhvilluara në këto njësi.

Berati është zhvilluar si qendër rajonale për agrobiznesin, tregtinë dhe turizmin. Kjo si rrjedhojë e pozicionit gjeografik dhe aksesit me rrugët kombëtare.

### **Nxitja e eventeve kulturore dhe kthimi i Beratit në një Destinacion Tërheqës për vizitorët dhe një qytet ku të gjithë banorët mund të argëtohen dhe socializohen.**

Berati është kthyer në një Destinacion Ndërkombëtar turistik, me një përqindje të rritjes së numrit të turistëve **50 % për vitin 2016** krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2015, referuar shitjeve të biletave në Kala. Po sipas këtij burimi informacioni në pikun e turizmit janë mesatarisht rreth **700 turistë në ditë** të cilët vizitojnë qytetin, duke e kthyer Beratin në një destinacion të rëndësishëm kulturor dhe të eko-turizmit. Trashëgimisë kulturore si SIT në Unesco, i bashkohen vlerat e 4 njësiteve të reja administrative të cilat ofrojnë monumente të trashëgimisë kulturore dhe natyrore të cilat janë të aksesueshme për turistet, duke bërë të mundur shtimin e kohëqendrimit të vizitorëve në Berat.

Bashkia Berat këtë vit ka priorizuar organizimin e Eventeve Kulturore, duke e kthyer Beratin në një destinacion tërheqës për vizitorët vendas dhe të huaj, gjatë orëve të mbrëmjes sidomos fundjavave duke plotësuar tur-in e vizitorëve në atraksionet e qytetit, me argëtimet në qendrën e qytetit. Këto evente, të cilat filluan në 18-Maj me hapjen e Sezonit Turistik, do të kthehen në evente të përvitshme, të cilat do pasurojnë eksperiencat e vizitorëve dhe jetën sociale të banorëve.

Në vitin në vijim, Bashkia Berat në politikën e saj e sheh edhe **trashëgiminë si një burim zhvillimi**. Në vitin 2017, do të punohet afër me komunitetin për zhvillimin e tij duke u bazuar në vlerat e trashëgimisë shpirtërore dhe materiale. Fokusi do të jetë të zhvillimi **i artizanatit, aksesit në treg i artizanëve, përmirësimi i produkteve të tyre si dhe rritja e të ardhurave**. Komunitet që ndodhet në zonat e trashëgimisë do të ndihmohen të krijojnë strategji për zhvillim përmes turizmit dhe njëkohësisht do të studiohen dhe dokumentohen në **mënyrë dixhitale vlerat e trashëgimisë** në mënyrë që ato të mos humbasin apo tjetërsohen duke u përshtatur si rrjedhojë e presionit të turizmit.



## KAPITULLI II

### ANALIZA E REALIZIMIT TE TREGUESVE TE BUXHETIT TE VITIT 2016

#### Informacion i pergjithshem i buxhetit te vitit 2016.....

Reforma Administrative Territoriale e vitit 2015, ne zbatim te Ligjit Nr. 115/2014 “Per ndarjen administrative-territoriale te njesive te qeverisjes vendore ne Shqiperi” si dhe VKM Nr. 510 date 10.06.201, është tashmë një realitet i prekshëm që ka ndihmuar forcimin e decentralizimit të njësive të qeverisjes vendore në gjithë vendin. Impakti i kësaj reformë kyçe ka sjellë përfitime të dukshme. Deri tani janë kursyer 12 milionë dollarë nga shkurtimi i shpenzimeve administrative dhe janë mbledhur 15 milionë dollarë më shumë të ardhura nga taksat vendore, krahasuar me një vit më parë.

Viti 2016 shënon një tjetër moment historik të decentralizimit dhe të autonomisë së pushtetit vendor. Zgjedhjet vendore të vitit 2015, shënuan fillimin e qeverisjes vendore sipas ndarjes së re administrativo-territoriale. Transferta e pakushtëzuar për njësitë e qeverisjes vendore për vitin 2016 u parashikua në nivelin 14.3 miliardë lek ose rreth 16% më shumë se në vitin 2015.

➤ **Kjo shumë përfshin fondin prej 1.16 miliard lek për:**

(i) konviktet,

(ii) qendrat sociale

(iii) dhe rrugët rurale;

➤ fondin prej 1.3 miliard lekë që qeveria ka vënë në dispozicion të njësive vendore për të kompensuar heqjen e taksës së biznesit të vogël si dhe;

➤ fondin rezervë prej 100 milion lek për t’u shpërndarë gjatë vitit fiskal për korrigjime të efekteve të formulës dhe financimit të funksioneve të reja.

Transferta për vitin 2016 u shpernda sipas një formule të re të hartuar me kontributin e projektit të Planifikimit dhe Qeverisjes Vendore të financuar nga USAID, e cila bazohet në:

a. të dhënat e popullsisë,

b. dendësinë e popullsisë

c. numrit të nxënësve në shkolla.

d. Në formulë parashikohet një harmonizim i të dhënave të popullsisë sipas Census-it dhe Gjendjes Civile, si dhe një ekualizim fiskal duke kompensuar njësitë me dendësi të popullsisë dhe kapacitet fiskal më të ulët.

Një tjetër risi e buxhetit për vitin 2016 është detyrimi i Bashkive për të përdorur jo më pak se 40% të transfertës së pakushtëzuar për investime.

e. Në lidhje me paketën fiskale të vitit 2016, ndryshime të rëndësishme lidhen me taksën e pasurisë, ku Qeveria propozon vendosjen e taksës mbi truallin (jo-hapësirë publike) dhe detyrimin për përdoruesin e pasurisë së paluajtshme për të vetëdeklaruar sipërfaqen e pasurisë dhe për të paguar taksën.

f. Një ndryshim lidhet me përjashtimin nga Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin i Bizneseve të Vogla me qarkullim vjetor 0-5 milionë lek



## BASHKIA BERAT

- g.* uljen e shkallës tatimore nga 7,5 % në 5 % të këtij tatimi për ato me qarkullim vjetor 5-8 milion lek.
- h.* Efekti financiar i kësaj politike vlerësohet në rreth 1.3 miliardë lek, të cilat i janë shtuar transfertës së pakushtëzuar, e për rrjedhojë ndahen nëpërmjet formulës.
- i.* Kjo politike rezulton në ulje të ardhurash për Bashkitë.
- j.* Gjithashtu edhe taksa vendore për fjetjen në hotel propozohet të reduktohet nga 5% e çmimit të fjetjes që është aktualisht, në nivelin 140 lek për person/për natë qëndrimi.
- k.* Përsa i përket funksioneve të reja që u transferohen njërive të qeverisjes vendore, ato do të financohen nëpërmjet **transfertave specifike për çdo funksion dhe për çdo njësi**.
- l.* Fondet për funksionet e lidhura me bujqësinë, ujitjen dhe kullimin u transferuan nga Ministria e Bujqësisë tek Bashkitë si dhe të u shpernda ndërmjet 61 Bashkive, fondin prej rreth 2.5 miliard lekë për investimet e nevojshme në infrastrukturën e ujitjes dhe kullimit.
- m.* **Fondi për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2016**, u parashikua në nivelin 10 miliardë lekë, dhe do të përdoret për financimin e tre shtyllave kryesore:
  - D.* programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale vendore,
  - E.* programi Shqipëria dixhitale
  - F.* një program i ri që parashikohet të mbështesë ekonominë vendore.
- G. Risi të tjera të rëndësishme lidhen me krijimin e Agjencisë Kombëtare për Zhvillimin e Rajoneve dhe katër Agjencive të tjera për Zhvillimin e Rajoneve që do të operojnë në nivel rajonal. Gjithashtu, për dy shtyllat e Mbështetjes së Ekonomisë dhe **“Shqipëria Dixhitale”**, përveç Bashkive, për herë të parë parashikohet mundësia e financimit të skemave të granteve me përfitues individë dhe subjekte private

Janë vendosur kritere dhe tavane që garantojnë funksionimin normal të të gjitha njërive të qeverisjes vendore.

- ✓ Për vitin 2016, transfertat e pakushtëzuar do të ndahet në 61 NJQV, sipas kritereve të mësipërme, por duke rifreskuar të dhënat për popullsinë, kapacitetet fiskale dhe tregues të tjerë të varfërisë.
- ✓ Buxheti vjetor të vitit 2016 I shtohet dhe **transferta specifike** për financimin e funksioneve të reja që I shtohen bashkisë
- ✓ **Fondi i Zhvillimit të Rajoneve**, i provuar si një skemë financimi e sukseseshme merr rëndësi akoma më të madhe në buxhetin e vitit 2016. Objektivat madhore të qeverisë për rilindjen e qyteteve dhe të qendrave të tjera zhvillimore, gjejnë mbështetjen e plotë në skemën e financimit të investimeve nëpërmjet Fondit të Zhvillimit të Rajoneve.
- ✓ Rritja e konsiderueshme e fondit në këtë skemë bën që buxheti vendor të jetë më i madhi në historinë e tij.

Buxheti vendor i vitit 2016, me tërë komponentët e tij (transfertë e pakushtëzuar, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, renta minerare dhe të ardhurat e veta) në këndvështrimin makroekonomik, buxheti 2016 ben te mundur

### ZHVILLIMET FISKALE GJATE VITIT 2016

Risite dhe risqet që na shoqëruan gjatë vitit 2016 me ndikim me të ardhurat e bashkisë Berat.



## BASHKIA BERAT

- Në kuadër të reformës territoriale zgjerimi i vijës administrative të Bashkisë do të rrisë potencialin e të ardhurave të Bashkisë Berat, por do të kërkojë edhe rritje të strukturës së administratës tatimore vendore.
- **Ulet taksa** për ndërtesat që përdoren për veprimtari prodhuese.
- Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i shtohet një komponent, **taksa mbi truallin** (jo tokë bujqësore) e cila ndahet në dy kategori, sipas përdoruesve të truallit që përdoret për qëllime banimi nga individët dhe për truallin që përdoret për qëllime biznesi.
- Ndryshohet taksa e **fjetjes në hotel**. Kjo taksë nga 5% e çmimit të fjetjes që ka qënë më përpara vendoset në disa nivele të ndryshme, në përputhje me kategorizimin e bashkisë dhe llojin e njësive akomoduese.
- Takseës së ndikimit në infrastrukturë nga **ndërtimet e reja** i bëhet një shtesë, sipas së cilës në rastin e ndërtimeve për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo për përdorim publik, taksa e ndikimit në infrastrukturë rritet në masën **4% deri 8%** të çmimit të shitjes për metër katror.
- Ndryshohet **taksa e tabelës**. Përkatësisht detajohet dhe riklasifikohet taksa e tabelës për qëllime identifikimi si dhe detajohet, për sa i përket nivelit të taksës, taksa e tabelës për qëllime reklamimi.
- Taksa e zënies së hapësirave publike riklasifikohet **si tarifë**. Kjo për arsye se zënia e hapësirave publike për qëllime biznesi është qiradhënie dhe jo taksë. Përcaktimi si tarifë do të mundësojë një vendimarrje më të plotë
- Permiresimi i shërbimit ndaj tatimpaguesve si rrjedhojë e shtrirjes në njësitë administrative dhe zyrat e taksave ku paguhen taksat e familjes të sistemit bashkëkohor informatik tatimor TAIS për administrimin e taksave dhe tarifave vendore. Kjo do të sjellë uljen e kohës së shërbimit ndaj tatimpaguesve dhe ulje të punës manuale të specialistëve.
- ✓ **Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël ndryshon nivel**. Pa dyshim që zerimi i këtij tatimi për subjektet e biznesit me qarkullim vjetor deri në 5 milion lekë, është një nga efektet më negative në kurriz të të ardhurave të Bashkisë Berat. Në këto dy vjet që ky tatim po administrohet nga administrata tatimore qëndrore, ky tatim është ndryshuar disa herë. Me ndryshimet më të fundit fiskale ky tatim përveç se hiqet për subjektet me xhiro deri në 5 milion lekë por edhe ulet me ulet me 2.5% nga 7.5% e fitimit të tatueshëm në 5% e fitimit të tatueshëm si dhe për këtë kategori biznesi është hequr pragu minimal i pagesës prej 25,000 lekë/vit.
- ✓ **Kapacitetet e ulta fiskale të njësive administrative** që na bashkohen kanë efekte në buxhetin total të Bashkisë.

## PLANI FINANCIAR I BASHKISË BERAT

Buxheti i Bashkisë Berat u miratua me Vendimin e Keshillit të Bashkisë Nr. 58 date 28 .12.2015 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2016”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresën nr. 3273/1 date 31.12.2015, dhe pas celjes së tij nga dega e thesarit filloj zbatimi i tij .



## BASHKIA BERAT

Ne zbatim te Ligjit Nr. 115/2014 “Per ndarjen administrative-territoriale te njesive te qeverisjes vendore ne Shqiperi” si dhe VKM Nr. 510 date 10.06.2014, Bashkia Berat vijoj procedurat si njesi e re administrative e Re.

Ne mbeshtetje te ligjit nr.147/2015 “Per buxhetin e vitit 2016”, Udhezimit te Ministrit te Financave nr. 2 date 06.02.2012 “Per procedurat standarte te zbatimit te Buxhetit”, Bashkia Berat miratoi :

ne 000 / leke.

**A - Te ardhurat gjithsej (I +II).....762622**

I - Te ardhurat e buxhetit te pavarur.....330 000

- Te ardhurat Lokale (Plan i vitit 2016.....330 000.

II - Transferta gjithsej.....432 622

- Transferta e pa kushtezuar.....219580

- Transferta e specifikave .....213 042

**B - Shpenzimet gjithsej .....762 622**

-Shpenzime operative.....448 680

-funksionet specifikave.....213 042

-Shpenzime kapitale..... 100 900

Gjate procedures se zbatimit te buxhetit, pas ndyshimeve te bera dhe transaksioneve financiare te ndodhura ne vitin 2016 , dhe te vendimuara ne Keshillin Bashkiak, ne fund te vitit 2016 rezulton kjo situat e financiare:

1. Transferta e pakushtezu.....219 580

2. Transferta e per funksionet..... 213 042.

3. Te ardhurat e vitit ( I pritshmi vjetor )..... 287 000

4. Te trasheguara nga vitit 2015 ne vitin 2016..... 79 541

**TOTALI I TE ARDHURAVE.....799 163**

Sipas natyres se shpenzimit, perdorimi i fondeve gjate vitit 2016, ( realizimi I pritshem ) ne menyre te permbledhur paraqitete si me poshte:

1. Shpenzime per pagat .....317 534.

2. Shpenzime per sig.shoqerore dhe shendetesore..... 51 258

3. Shpenzime operative..... ...217 378

4. Investime (nga te ardhurat lokale).....102 905

**TOTALI I SHPENZIMEVE.....689 075**



## BASHKIA BERAT

Viti buxhetor 2016 i planifikuar i **balancuar**, pergjithesisht paraqitet me tregues pozitiv. **Trasheguam** nga viti 2015 te ardhura ne shumen totale prej **79 541 000** leke. Sipas pritshmerise se realizimit te buxhetit mund te trashegojme rreth 110 000 000 leke, por jane dhe procedura prokurimi ne process per muajin dhjetor qe do te trajtohen ne kapitullin perkates.

Duke qene se materiali eshte punuar gjate muajit dhjetor, eshte punuar ne baze te pritshmerise se realizimit te treguesve, e ardhura qe do te trashegohet nga vitit 2016 , do te rakordohet me degen e thesarit ne fillim te muajit janar 2017.

### ANALIZA E PLANIT TE TE ARDHURAVE.

- Në total, për vitin 2016, të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore të Bashkisë Berat përfshirë dhe njësitë administrative Roshnik, Sinjë, Velabisht dhe Otlak, priten të realizohen në shumën 285,548,000 lekë kundrejt planit vjetor prej 330,000,000 lekë ose 87%.
- Në total kundrejt realizimit faktik të vitit 2015 prej 245,103,000 lekë të ardhurat e vitit 2016 priten të realizohen me +40,445,000 lekë ose +14 % më shumë se realizimi i vitit të kaluar.

Pra përfshirja e njërive administrative në territorin e Bashkisë Berat ka dhënë efekte pozitive në të ardhura, megjithëse kontributi i tyre është i vogël krahasur me të ardhurat e grumbulluara nga bashkia qëndër.

Tabela e mëposhtme paraqet një informacion mbi realizimin e të ardhurave totale nga taksat dhe tarifat vendore sipas viteve.

#### Pasqyra nr. 2

në /000 lekë

Vitet	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Të ardhurat totale	143,276	159,710	225,715	181,877	186,240	167,986	186,426	200,002	239,149	285,548

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme shohim se viti 2016 përbën vitin më të mirë të realizimit të të ardhurave në këto 4 vitet e fundit. Natyrisht që ndikim të konsiderueshëm ka, sic e thamë edhe më lartë, përfshirja e njërive administrative në territorin e Bashkisë Berat.

#### Grafiku nr. 3

#### Ecuria në vite e të ardhurave totale




Tabela e mëposhtme paraqet një informacion mbi realizimin e të ardhurave të pritshme të vitit 2016 sipas grupeve kryesore.




## BASHKIA BERAT

Emërtimi	Të ardhurat në /000 lekë	Realizimi (në %)
Të ardhura nga taksa vendore mbi biznesin e vogël	10,000	29
Të ardhura nga taksat vendore	141,325	94
Të ardhura nga tarifat vendore	103,700	100
Të ardhura nga Drejtoria Ekonomike e Arsimit	10,500	89
Të ardhura të tjera	20,023	87
Të ardhura nga legalizimet	0	0
<b>TOTALI</b>	<b>285,548</b>	<b>87</b>

### Grafiku nr. 4

#### Realizimi i të ardhurave të pritshme të vitit 2016 sipas grupeve kryesore



Nga të dhënat rezulton se peshën kryesore në të ardhurat e realizuara e zënë të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore, duke përjashtuar këtu ndikimin që ka pasur në vite me parë tatimi i thjeshtuar mbi fitimin.

Nga të dhënat e tabelës dhe nga grafiku i mësipërm vërehet se përgjithësisht të ardhurat janë realizuar në nivel të kënaqshëm.

Në mënyrë më të detajuar të ardhurat sipas grupeve kryesore dhe nën grupeve paraqiten në pasqyrën e mëposhtme.

### Pasqyra nr. 3

Nr	Emertimi/Muaji	12 Mujori							
		Fakti 2015	Plan 2016	Fakti 11 Mujor 2016	I pritshmi 2016	Realizimi ne % I 2016	Plani 2017	Plani 2018	Plani 2019
I	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin per biznesin e vogel	45,687	34,964	7,483	10,000	29%	10,143	12,507	12,882



BASHKIA BERAT

II	Taksat vendore	95,302	150,515	134,876	141,325	94%	166,320	171,309	176,449
1	Takse table	2,373	3,938	8,330	8,750	222%	8,843	9,108	9,382
•	Tabelë për qëllime identifikimi	327	957	5,625	5,900	617%	6,664	6,864	7,070
•	Tabelë për qëllime reklamimi	2,046	2,981	2,705	2,850	96%	2,179	2,244	2,312
2	Te ardhura nga zënia e hapsirave publike	14,381	15,842	14,850	15,000	95%	14,533	14,969	15,418
3	Takse ndikimi ne infrastrukture nga ndertimet e reja	15,908	30,000	24,051	24,300	81%	30,000	30,900	31,827
4	Takse fjetje ne hotel	1,675	1,936	2,658	2,800	145%	2,869	2,955	3,044
5	Takse mbi token bujqesore	6,316	19,069	11,172	11,400	60%	18,406	18,958	19,527
6	Takse e mjeteve te perdorura	14,253	19,700	17,110	19,950	101%	20,510	21,125	21,759
7	Takse e kalimit te se drejtes se pronesisë pronësisë	1,545	3,000	1,793	2,100	70%	3,000	3,090	3,183
8	Takse mbi ndertesat	38,851	49,579	48,136	49,500	100%	59,134	60,908	62,735
•	Biznes	31,917	41,450			0%	49,990	51,489	53,034
•	Familje	6,934	8,129			0%	9,144	9,419	9,701
9	Takse Trualli		3,451	6,756	7,500	217%	8,010	8,250	8,498
10	Te tjera taksa lokale	-	4,000	20	25	1%	1,015	1,045	1,077
III	Tarifat vendore	84,390	103,670	100,292	103,700	100%	111,846	115,202	118,658
1	Tarife e pastrimit	49,738	55,056	55,569	56,500	103%	65,380	67,341	69,362
•	Biznes	32,856	37,499			0%	41,697	42,948	44,236
•	Familje	16,882	17,557			0%	23,683	24,393	25,125
2	Tarife e ndriçimit publik	14,928	21,986	21,884	22,200	101%	25,576	26,343	27,133
•	Biznes	3,980	7,463			0%	8,858	9,124	9,397
•	Familje	10,948	14,522			0%	16,718	17,220	17,736

**BASHKIA BERAT**

3	Tarife gjelberimi publik	5,186	10,827	10,650	12,000	111%	13,371	13,772	14,185
•	Biznes	1,451	4,879			0%	6,228	6,414	6,607
•	Familje	3,735	5,948			0%	7,143	7,357	7,578
4	Tarife regjistrim veprimtarie biznesi	3,943	1,445	2,533	2,650	183%	1,240	1,277	1,316
5	Tarifa urbanistike	353	300	28	30	10%	300	309	318
6	Tarifa te sherbimit administrativ	1,856	700	1,543	1,600	229%	700	721	743
7	Tarife per license/certifikate ne fushen e transportit rrugor	1,814	1,900	1,124	1,300	68%	1,900	1,957	2,016
8	Tarifa per zenien e sallave dhe celje kartelexuesi	-	275	100	150	55%	275	283	292
9	Tarifa te sherbimit te varrimit	5,854	6,000	6,103	6,400	107%		0	-
10	Tarife per lende drusore	593	1,195	11	20	2%	1,995	2,055	2,116
11	Tarife uji i pijshem		3,256	169	200	6%	50	52	53
	Tarife therje	125	320	168	200	63%	365	376	387
12	Te tjera tarifa		410	410	450	110%	695	716	737
<b>IV</b>	<b>Tarifa te Drejtorise Ekonomike te Arsimit</b>	<b>9,921</b>	<b>11,800</b>	<b>9,255</b>	<b>10,500</b>	<b>89%</b>	<b>12,400</b>	<b>12,772</b>	<b>13,155</b>
1	Te ardhura nga konviktet	1,065	1,200	789	900	75%	1,200	1,236	1,273
2	Te ardhura nga cerdhet	2,977	3,700	2,947	3,100	84%	4,000	4,120	4,244
3	Te ardhura nga kopshtet	5,879	6,900	5,519	6,500	94%	7,200	7,416	7,638
<b>V</b>	<b>Te ardhura te tjera</b>	<b>9,803</b>	<b>23,051</b>	<b>9,585</b>	<b>20,023</b>	<b>87%</b>	<b>123,718</b>	<b>127,430</b>	<b>131,252</b>
1	Te ardhura nga parkimi	1,350	2,551	2,518	2,650	104%	1,923	1,981	2,040
2	Te ardhura nga qerate	4,996	7,529	2,870	12,900	171%	104,363	107,494	110,719
3	Te ardhura nga gjobat, k. vonesa etj..	3,031	10,111	3,509	3,600	36%	1,400	1,442	1,485

**BASHKIA BERAT**

4	Te tjera te ardhura nga pronesia	254	1,000	665	850	85%	1,000	1,030	1,061
5	Te ardhura nga biletat	20	200			0%	-	0	-
6	Te tjera debitore dhe gjyqe	152	1,660	23	23	1%	15,032	15,483	15,947
<b>VI</b>	<b>Te ardhura nga legalizimet</b>	-	<b>6,000</b>			<b>0%</b>	<b>6,000</b>	<b>6,180</b>	<b>6,365</b>
<b>TOTALI</b>		<b>245,103</b>	<b>330,000</b>	<b>261,491</b>	<b>285,548</b>	<b>87%</b>	<b>430,427</b>	<b>445,400</b>	<b>458,762</b>

**Të ardhurat e pritshme nga taksat dhe tarifat vendore për vitin 2017-2019** në /000 lekë.

Nga të dhënat e pasqyrës së mësipërme shohim se plani vjetor i të ardhurave të vitit 2016 pritet të realizohet në masën 87 %, me një mosrealizim në shumën 44,452,000 lekë (tatim i thjeshtuar mbi fitimin ,se bashku me te ardhurat nga legalizimet).

Peshën më të madhe në këtë mosrealizim kryesisht e kanë 2 zëra të të ardhurave të cilët në total kanë një efekt në mosrealizimin e të ardhurave me rreth -44.452.000 lekë ose – 13. % të planit të të ardhurave totale të vitit 2016.

- **Mos realizimi i të ardhurave të planifikuara nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël**,kjo per arsye se ka pasur ndryshime ne legjislacion ,duke u ndryshuar kategorizimi per tatimpaguesit ne baze te qarkullimit.Subjektet me qarkullim nga 0 deri ne 5(pese) milion leke ne vit ,niveli i kesaj takse eshte 0(zero) leke.

- **Mos realizimi i të ardhurave të planifikuara nga legalizimet**, të ardhura të cilat mblidhen nga A.L.U.I.Z.N.I. është në nivele shumë të ulëta në këto 5 vjet radhazi..

Efekti në të ardhurat e Bashkisë nga mosrealizimi i të ardhurave nga mosrealizimi i të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja që janë në proces legalizimi është rreth - 5,952,000 lekë.

-**Mos arkëtimi i të ardhurave të planifikuara nga taksa mbi tokën bujqësore**, të ardhura të cilat mblidhen kryesisht nga Njësite administrative. Të ardhurat nga ky zë, janë ndër burimet kryesore të të ardhurave nga këto njësi dhe natyrisht që duhet një punë e fortë në realizimin e këtyre të ardhurave.

Efekti në të ardhurat e Bashkisë nga mosrealizimi i të ardhurave nga taksa mbi tokën bujqësore është rreth - 7,669,000 lekë.

**Pasqyra nr. 4****Ecuria në vite e të ardhurave nga taksa vendore mbi biznesin e vogël dhe tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël** në /000 lekë

Vitet	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Taksa + Tatimi	52,334	41,667	55,309	53,640	49,740	51,892	45,839	41,649	34,615	45,856	10,000

Ndjekja e këtij tatimi i kaloi Drejtorive Rajonale Tatimore në rolin e agjentëve tatimorë, shërbim për të cilin përfitojnë 1% të vlerës së arkëtuar. Shihet se, realizimi i të ardhurave nga ky zë është më i ulët në raport me të ardhurat në vitet e mëparshme, kur këto të ardhura mblidheshin nga Bashkia Berat. Madje në këtë drejtim janë bërë hapa pas, pasi edhe duke arkëtuar të ardhura nga një numër më i madh biznesesh (si rezultat i rritjes së



## BASHKIA BERAT

numrit të bizneseve të regjistruar dhe përfshirjes së subjekteve të katër njësive administrative) të ardhurat e mbledhura nga agjenti tatimor nuk arrijnë dot të ardhurat kur ky tatim administrohej nga strukturat e bashkisë. Gjithashtu u ndryshua kategorizimi për tatimpaguesit në baze të qarkullimit. Subjektet me qarkullim nga 0 deri në 5 (pese) milion leke në vit, niveli i kesaj takse është 0 (zero) leke.

Në total të ardhurat nga Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël :

- Për vitin 2016 priten të realizohen në shumën 10,000,000 lekë kundrejt planit vjetor prej 34,964,000 lekë ose 29 %.
- Kundrejt realizimit faktik të vitit 2015 prej 45,687,000 lekë të ardhurat e vitit 2016 priten të realizohen me - 35,687,000 lekë më pak se realizimi i vitit të kaluar.

Një efekt të konsiderueshëm ka fakti se subjektet kanë paguar në nivelin minimal të përcaktuar.

Shumica e tatimpaguesve të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël i përkasin kategorisë së xhiros deri në 2 milion lekë. Shumë pak tatimpagues e kalojnë këtë prag.

Për vitin 2016 me ndryshimet që i janë bërë ligjit nr. j 9632 date 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” tatimpaguesit me xhiro deri në 5 milion lekë përjashtohen nga pagesa e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin. Gjithashtu ulet me 2.5% tatimi për subjektet me xhiro 5 deri në 8 milionë lekë/vit si dhe hiqet pragu minimal i pagesës së tatimit nga tatimpaguesit prej 25 mijë lekë/vit. Si rrjedhojë, efektet financiare për buxhetin e bashkisë Berat nga heqja e këtij tatimi janë tejet të rënda, pasi ky tatim është ndër zërat kryesore të buxhetit të bashkisë sonë.

Sic e kemi theksuar, nevojitet që agjenti tatimor të ushtrojë kontrole të imtësishme të pasqyrave financiare të paraqitura nga këto kategori biznesesh, gjë e cila duhet të reflektohet në rritje të të ardhurave që duhet të kalojnë Bashkisë Berat.


Grafikisht paraqesim të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël si dhe nga taksa vendore mbi biznesin e vogël ( në kohën kjo taksë ekzistonte).

### Grafiku nr. 5

**Ecuria në vite e të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin dhe taksa vendore mbi biznesin e vogël**



## BASHKIA BERAT



### a. Të ardhurat nga taksat vendore

Kryesisht këto të ardhura mblidhen nga Bashkia Berat si dhe nga agjentët tatimorë.

- Të ardhurat nga taksat vendore për vitin 2016 priten të realizohen në shumën 141,325,000 lekë kundrejt planit vjetor prej 150,515,000 lekë ose 94 %.
- Kundrejt realizimit faktik të vitit 2015 prej 95,302,000 lekë të ardhurat e vitit priten të realizohen me +46,023,000 lekë ose +33 % më shumë se realizimi i vitit të kaluar.

Zërat më me peshë në këtë grup të ardhurash janë taksa e ndikimit në infrastrukturë, taksa mbi ndërtesat, mbi truallin, Takse e tabelës, Takse fjetje ne hotel, të ardhurat nga zënies së hapësirave publike si dhe taksa e mjeteve të përdorura.

Nivel shumë të mirë realizimi paraqesin taksa e tabelës për qëllime identifikimi, taksa mbi ndërtesën që arkëtohet nga biznesi, e cila në pesë vitet e fundit shënon rritje nga njëri vit në tjetrin, taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë, taksa e mjeteve të përdorura, taksa e fjetjes në hotel dhe përgjithësisht të ardhurat nga zënia e hapësirave publike.

Për zërat e të ardhurave nga taksa mbi tokën bujqësore dhe nga taksat mbi ndërtesat (si për familjet ashtu edhe për biznesin), arkëtimi i vitit 2016 është në nivelin më të lartë që është realizuar gjatë periudhës 2005-2015.

Efektin dominues në mosrealizimin e të ardhurave nga taksat vendore e ka mosrealizimi i të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë (leje ndertimi) dhe nga taksa mbi tokën bujqësore. Është pikërisht mosrealizimi i të ardhurave të planifikuara nga lejet e ndërtimit, i cili sikurse e theksuam më sipër, si rjedhojë e ndryshimeve që iu bene ligjit të urbanistikës dhe bllokimit të dhënies së lejeve të ndërtimit per nje periudhe kohe.

### **Pasqyra nr. 5**

#### **Ecuria në vite e të ardhurave nga taksat vendore** në /000 lekë

Vitet	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Taksat vendore	49,725	48,529	55,396	85,395	73,565	74,966	65,146	63,867	70,361	88,895	141,325

Karakteristikë e të dhënave të pasqyrës së mësipërme është fakti se gjatë gjithë periudhës vazhdon trendi rritës i të ardhurave nga taksat vendore. Viti aktual 2016 shënon pikën maksimale të arkëtimeve nga taksat vendore.


Më qartë ecuria në vite e të ardhurave nga taksat vendore shihet në grafikun e mëposhtëm.

### **Grafiku nr. 6**



## BASHKIA BERAT

### Ecuria në vite e të ardhurave nga taksat vendore



#### **b. Të ardhurat nga tarifat vendore**

Kryesisht këto tarifa mbliidhen nga Drejtoria e Taksave Regjistrimit të Biznesit dhe Tregjeve, nga Njësitë administrative dhe agjenti tatimor sh.a Ujësjiellës Kanalizime Berat – Kucovë.

- Të ardhurat nga tarifat vendore për vitin 2016 priten të realizohen në shumën 103,700,000 lekë kundrejt planit vjetor prej 103,670,000 lekë ose 100 %.
- Kundrejt realizimit faktik të vitit 2015 prej 84,390,000 lekë të ardhurat e vitit 2016 janë realizuar me +19,310,000 lekë ose +19 % më shume se realizimi i vitit të kaluar.

Zërat më me peshë në këtë grup të ardhurash janë tarifat vendore të pastrimit, ndricimit, gjelbërimit që mbliidhen nga biznesi dhe nga familjet

Të ardhurat nga tarifat vendore paraqesin nivel shumë të mirë realizimi.

Përveç realizimit në nivel shumë të mirë të tarifave mbi biznesin, efekt në realizimin e të ardhurave nga tarifat vendore ka edhe realizimi i të ardhurave nga tarifat e familjes dhe kjo si rezultat i faturimit të këtyre tarifave së bashku me faturën e ujit të pijshëm.

Nivel shumë të mirë realizimi shënoi edhe tarifa e regjistrimit për subjektet e rinj të biznesit që tregon punë të mirë të kryer në drejtim të uljes së informalitetit, por që duhen shfrytëzuar të gjitha potencialet në drejtim të regjistrimit të subjekteve që u shmangen detyrimeve tatimorë.

Realizim shumë të mirë kanë edhe të ardhurat nga tarifat e institucioneve shtetërore.

Theksojmë se Bashkia Berat i ka kushtuar vëmendje maksimale arkëtimit të të ardhurave nga tarifat e familjes. Nëpërmjet futjes së këtyre tarifave së bashku me faturën e ujit të pijshëm është zgjeruar baza e tatimpaguesve dhe ka sjellë rezultate poitive në buxhetin e bashkisë.

Gjithashtu ndaj cdo qytetari, i cili kërkon që ti ofrohet një shërbim i caktuar administrativ nga bashkia, kërkohet që ai të paraqesë librezën e taksave ku të ketë likujduar taksat dhe tarifat vendore.

Në drejtim të rritjes së të ardhurave nga familjet kemi kërkuar edhe mbështetjen e gjithë drejtorive rajonale për pagesën e detyrimeve të punonjësve të tyre, por që nuk kemi gjetur mbështetje në të gjitha këto struktura.

#### **Pasqyra nr. 6**

#### **Ecuria në vite e të ardhurave nga tarifat vendore      në /000 lekë**

Vitet	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Tarifat vendore	29,331	31,387	35,334	52,489	36,369	35,599	35,816	40,857	70,361	82,156	103,700




## BASHKIA BERAT

Karakteristikë e të dhënave të pasqyrës së mësipërme është fakti se pothuajse gjatë gjithë periudhës vazhdon trendi rritës i të ardhurave nga tarifatat vendore. Viti 2016 shënon pikën maksimale të arkëtimeve nga tarifatat vendore.

Më qartë ecuria në vite e të ardhurave nga tarifatat vendore shihet në grafikun e mëposhtëm.

### Grafiku nr. 7

#### Ecuria në vite e të ardhurave nga tarifatat vendore



#### c. Të ardhurat nga Drejtoria Ekonomike e Arsimit

Këto tarifa mblihen nga Drejtoria Ekonomike e Arsimit

- Të ardhurat nga Drejtoria Ekonomike e Arsimit për vitin 2016 priten të realizohen në shumën 10,500,000 lekë kundrejt planit vjetor prej 11,800,000 lekë ose 89 %.
- Kundrejt realizimit faktik të vitit 2015 prej 9,921,000 lekë të ardhurat e vitit 2016 priten të realizohen me +579,000 lekë ose përafërsisht në të njëjtën përqindje sa realizimi i vitit të kaluar.

### Pasqyra nr. 7

#### Ecuria në vite e të ardhurave nga Drejtoria Ekonomike e Arsimit në /000 lekë

Vitet	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Të ardhura nga D.E.A	13,853	15,900	8,704	8,864	10,568	10,908	9,657	9,239	10,204	10,249	10,500

Karakteristikë e të dhënave të pasqyrës së mësipërme është fakti se në 5 vitet e fundit nuk kemi luhatje të mëdha të arkëtimit të të ardhurave nga ky zë.

Viti 2007 shënon pikën maksimale të arkëtimeve nga të ardhurat e Drejtorisë Ekonomike të Arsimit.


Më qartë ecuria në vite e të ardhurave nga kjo Drejtori shihet në grafikun e mëposhtëm

### Grafiku nr. 8

#### Ecuria në vite e të ardhurave nga Drejtoria Ekonomike e Arsimit



## BASHKIA BERAT



### d. Te ardhurat e tjera

Këto të ardhura mbliidhen nga Drejtoritë e Bashkisë si dhe nga ndërmarjet e varësisë.

- Të ardhurat e tjera për vitin 2016 priten të realizohen në shumën 20,023,000 lekë kundrejt planit vjetor prej 23,051,000 lekë ose 87 %.
- Kundrejt realizimit faktik të vitit 2015 prej 9,803,000 lekë të ardhurat e vitit 2016 priten të realizohen me +10,220,000 lekë më shume së realizimi i vitit të kaluar.

Zërat më me peshë në këtë grup të ardhurash janë të ardhurat nga të ardhurat nga qeratat nga ndërtesat dhe pajisjet, të ardhurat nga parkimi, të ardhurat nga gjambat dhe të ardhurat e tjera.

Nivel shumë të mirë realizimi paraqesin të ardhurat nga qerate dhe të ardhurat nga parkimi.

### **Pasqyra nr. 8**

**Ecuria në vite e të ardhurave të tjera** në /000 lekë

Vitet	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Të ardhura të tjera	3,617	5,793	2,746	3,254	7,611	8,882	9,973	29,244	12,541	11,015	20,023


Karakteristikë e të dhënave të pasqyrës së mësipërme është fakti se kemi luhatje të arkëtimit të të ardhurave nga ky zë. Luhatjet në këtë zë janë më të mëdha për faktin se shpesh herë gjatë viteve nënzhërat e këtij grupi janë konfiguruar si pjesë e grupeve të tjera të të ardhurave. Megjithatë është për tu theksuar fakti se nga viti 2008 dhe në vazhdim vazhdon trendi rrites i të ardhurave të tjera. Më qartë ecuria në vite e të ardhurave të tjera shihet në grafikun e mëposhtëm.

### **Grafiku nr. 9**

**Ecuria në vite e të ardhurave të tjera**



## BASHKIA BERAT



### e. Të ardhurat nga legalizimet

Këto të ardhura mbliidhen nga agjenti A.L.U.I.Z.N.I, por kete vit, pritet me mosrealizim.

### Pasqyra nr. 9

#### Ecuria në vite e të ardhurave nga legalizimet në /000 lekë


Vitet	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Te ardhurat nga legalizimet	-	-	2,221	22,073	4,024	3,998	1,555	1,569	10	-	-

Viti 2014 shënon pikën minimale të arkëtimit nga të ardhurat nga legalizimet. Karakteristikë është fakti se pas vitit 2009, vit pas viti të ardhurat nga ky zë po shënojnë rënie.

Më qartë ecuria në vite e të ardhurave të tjera shihet në grafikun e mëposhtëm.

### Grafiku nr. 10

#### Ecuria në vite e të ardhurave nga



legalizimet



BASHKIA BERAT

ANALIZA E REALIZIMIT TE SHPENZIMEVE KORRENTE

Shpenzimet korrente ne total parashikohen te realizohen per vitin 2016 ne masen 87% ose ne vlere absolute ne shumen 407 746 000 leke, kundrejt 466 977 000 leke te planifikuara , ne vitin 2015 u realizuan 81%, ne vitin 2014 ku realizimi ishte 89 %,

		Shperndarja e shpenzimeve sipas programeve per periudhen 2015-2016						
Nr .			Fakt 2015			I Pritshmi 2016		
		Emertimi I programit	Shpenzime operative	Shpenzi me Kapitale	Totali I buxhetit	Shpenzi me operative	Shpenzime Kapitale	Totali I buxhetit
<b>1</b>	<b>Planifikim, menaxhim, administrim</b>		<b>128,958</b>	<b>1,095</b>	<b>130,053</b>	<b>129,980</b>	<b>48,570</b>	<b>178,550</b>
a		Administrata e bashkise	111,117	1,095	112,212	117,160	48,570	165,730
b		K.Bashk+k.fshatrave	6,702			7,360		
c		Shpenz.gjyqesore	332			1,772		
d		Keshilli I Qarkut	4,718		4,718	1,000		1,000
e		DRT	457			69		
f		BID Berati	1,191		1,191	72		72
g		Ujesjellesi,sha UK 2.5%	341			659		
h		Fond rezer ,fond emergjence	2,946			200		
i		Fondi I kontigjences	0			0		
j		Sherbimi Social	756			562		
k		Bono strehimi f.ne nevoje	398			1,126		
l		MZSH nga te ardhurat	0			0		
<b>2</b>	<b>Sherbimet Publike</b>	<b>Sherbime publike vendore</b>	<b>135,347</b>	<b>48,498</b>	<b>183,845</b>	<b>172,375</b>	<b>49,969</b>	<b>222,344</b>
a		Gjelberimi	32,154	4,631	36,785	37,775	300	38,075
b		Menaxhim I rrugor dhe ndicimi publik	44,599	43,867	88,466	65,700	49,669	115,369
c		Bujqesia			0	6,363		6,363



## BASHKIA BERAT

d	Pastrimi		56,293		55,603	62,408		62,408
e	Ujesjellesa/kuz		1,101		1,101	-		-
f	Tansporti Urban		1,200		1,200	-		-
g		Miremb. e varrez. publ. deshm.			436	129		129
h		Mirembajtja e lapidareve			0			-
i		Dekori I qytetit			254			-
<b>3</b>	<b>Arsimi parauniversitar dhe edukimi</b>		<b>53,872</b>	<b>12,948</b>	<b>66,820</b>	<b>49,499</b>	<b>3,284</b>	<b>52,783</b>
a		Arsimi parauniversitar dhe ai baze	53,872	290	54,162	32,203	3,284	35,487
b		Cerdhet		12,658	12,658	17,296		17,296
<b>4</b>	<b>Kultura, Turizmi,Rinia dhe Sportet</b>		<b>57,459</b>	<b>1,251</b>	<b>58,710</b>	<b>55,892</b>	<b>0</b>	<b>55,892</b>
a		Qendra Kulturore	23,823	1,251	25,074	21,247	0	21,247
b		Shume Sportet	3,936		3,936	4,645		4,645
c		Futbolli	29,700		29,700	30,000		30,000
<b>5</b>	<b>Qendra "Lira"</b>		<b>14,971</b>	<b>-</b>	<b>14,971</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali i buxhetit me fonde te bashkise</b>			<b>390,607</b>	<b>63,792</b>	<b>454,399</b>	<b>407,746</b>	<b>101,823</b>	<b>509,569</b>
<b>Funksionet e deleguara(Transf. Spec.)</b>						<b>178,424</b>	<b>1,082</b>	<b>179,506</b>
<b>5</b>	<b>Mbrojtja nga zjarri</b>	<b>Mbrojtja nga zjarri (PMNZSH)</b>	-	-	-	25,828		25,828
<b>6</b>	<b>Administrimi I pyjeve</b>	<b>Administrimi I pyjeve</b>	-	-	-	2,026		2,026
<b>7</b>	<b>Bordi I kullimit</b>	<b>Bordi Kullimit dhe ujitja</b>	-	-	-	2,967	1,082	4,049
<b>8</b>	<b>Rruget Rurale</b>	<b>Rruget Rurale</b>	-	-	-	4,607		4,607
<b>9</b>		<b>Arsimi parashkollor baze(Sherb. Mbeshtetes)</b>				111,253		111,253
<b>10</b>		<b>Konviktet + sherb.mbesht. Arsimi i mesem</b>				14,743		14,743
<b>11</b>	<b>Mbrojtja sociale (banesa</b>	<b>Qendra "Lira" + Mbrojtja sociale</b>				17,000		17,000



## BASHKIA BERAT

	sociale)							
	<b>Totali</b>		<b>390,607</b>	<b>63,792</b>	<b>454,399</b>	<b>586,170</b>	<b>102,905</b>	<b>689,075</b>


Pare ne menyre analitike, realizimi i planit te shpenzimeve eshte ne funksion te plotesimit te funksioneve te veta, te perbashketa dhe te deleguara te percaktuar qarte ne Ligjin nr.139/2015 "Per veteqeverisjen vendore".

### STRUKTURA FINANCIARE E BUXHETIT TE VITIT 2016


Te dhenat ne 000 leke

Nr.	Emertimi	Plan Buxheti	Buxheti I korrigjuar	I Pritshmi 2016	Pesha spec. ndaj tot. ne %	Realizimi ne %
1	Transferta e pakushtezuar	219,580	219,580	219,580	26	100
2	Transferta Specifike	213,042	213,042	213,042	25	100
3	Te ardhurat lokale	330,000	328,000	285,360	39	87
4	Te ardhura te trasheguara	79,542	79,542	79,542	9	100
<b>I</b>	<b>Totali i te ardhurave</b>	<b>842,164</b>	<b>840,164</b>	<b>797,524</b>	<b>100</b>	<b>95</b>
1	Shpenzime personeli		412,771	368,792	49	89
2	Shpenzime Operative		265,248	217,378	32	82
A	Shuma e shpenz. Korrente		678,019	586,170	81	86
B	Investime (TNO)		162,145	102,905	19	63
<b>II</b>	<b>Totali i Shpenzimeve</b>	<b>842,164</b>	<b>840,164</b>	<b>689,075</b>	<b>100</b>	<b>82</b>

#### Struktura financiare e te ardhurave te pritshme 2016



#### Struktura financiare e shpenzimeve te pritshme 2016





**Ne vitin 2015** shpenzimet operative ne total jane ne vleren 195,961,000 leke pra eshte pothuajse ne te njejtin nivel me vitin 2014 qe do te thote se eshte bere nje menaxhim I mire I financave ne drejtim te shpenzimeve operative me gjithë bashkimin e njesive adminiatrative te shkrira

**Ne vitin 2016** shpenzimet operative ne total u planifikuan 661 722 000 leke, parashikohen te realizohen ne total ne vleren **586 170 000** leke, ose **88.5%**. te cilat : Paga 317 534 000 leke, sigurime shoqerore 51 258 000 leke dhe shpenzime operative te mirembajtjes 217 378 000 leke leke , pra realizim I shpenzimeve eshte I barabarte me realizimin e planit te te ardhurave, qe tregon vemendjen e drejtorise se financeses ne ndjeken hap pas hapi te realizimit te treguesve : **te ardhura-shpenzime.**

#### Sipas ndarjes ekonomike analiza evidenton :

- **Perdorim eficient te fondeve** ne dispozicion ne perputhje me strukturen buxhetore te miratuar.
- **Zbatim korrekt te akteve ligjore e nenligjore** qe rregullojne perdorimin e tyre.
- **Pergjegjshmeri administrative dhe financiare** deri tek administrator me i drejteperdrejte per cdo shpenzim te kryer.
- **Ekonomizim, limitim te perdorimit te fondeve nga njesite shpenzuese** duke mos cenuar nivelin dhe cilesine e kryerjes se sherbimit.

➤ **Auditim dhe kontroll** te Njesite Shpenzuese dhe drejtorive per zbatimin e ligjishmerise nga njesia e auditit te brendshem dhe KLSH.Per Vitin 2016 Sektori i Auditimit të Brendshëm ka programuar 10 auditime, nga të cilat per periudhen 11 mujore jane realizuar 9 angazhime auditimi, nga te cilat 6 auditime me baze sistemi te plote dhe 3 auditime tematike.

Per Vitin 2016 krahas punes së mirë, në njesite publike që kemi audituar, janë konstatuar dhe të meta e mangësi si dhe shkelje te disiplines financiare me dëm ekonomik.

Ne zbatim te nenit 16, germa c te ligjit nr .114/2015 “Për auditimin e brendshem në sektorin publik”, për ndreqjen e parregullsive për subjektet e audituara kemi rekomanduar masa organizative, masa për zhdëmtim si dhe masa disiplinore të cilat kanë synuar të ulin mundësinë e përsëritjes në të ardhmen, konkretisht:



Rekomandimet për zhdermtim gjithsej sipas sistemeve janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Fusha e Zbulimit	V i t i 2 0 1 6		
		Lekë	Nr Personash	% Zbulimit
1	Sistemi i proçeseve organizative	20.173	3	40.5
2	Sistemi i pagesave	29.678	7	59.5
3	Sistemi i prokurimeve	0	0	0
4	Sistemi i të ardhurave	0	0	0
5	Sistemi i kontabilitetit	0	0	0
	Shuma	49.851	10	100

Peshën më të madhe të zbulimeve në masën 49 % të rekomandimeve për zhdermtim e zënë zbulimet në fushën e sistemit të pagesave. Zbulimet kanë ardhur si në zbatimin e gabuar të VKM nr 228, datë 13.04.2001 “ per dietat e nëpunësve që dergohen me sherbim jashtë vendbanimit të tyre” të ndryshuar me VKM 1198, date 03.12.2009, të ndryshuar me VKM nr 997, date 10.12.2010 “ Për trajtimin financiar të punonjësve që dergohen me shërbim jashtë qendres së punës, brenda vëndit „ shkelje të VKM nr 472, datë 02.07.2011 “ Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore”, etj, që kanë ardhur kryesisht nga mosnjohja e dispozitave ligjore, interpretimi i gabuar, llogaritja e gabuar e pagesave si dhe mungesa e dokumentacionit justifikues në bazë të dispozitave ligjore, përgatitja e ulët tekniko profesionale e stafeve dhe mungesa e kualifikimit.

Nga auditimet konstatojme se veprimtaria ekonomike-financiare e njesive të audituara nga viti në vite ka përmiresim të menaxhimit të fondeve, uljen e rasteve të shkeljeve, dhe një shprehje të vullnetit për përmiresim të rekomandimeve të lena.

Gjate vitit 2016 janë audituar njesite shpenzuese në varesi të Bashkise Berat sikurse edhe disa drejtori brenda struktures së Bashkise Berat.

Per vitin 2016 janë dhene gjithsej 45 rekomandime, nga të cilat 30 rekomandime të nivelit me risk të larte, 10 rekomandime me risk të mesem dhe 5 rekomandime me risk të ulet.



## BASHKIA BERAT

Shkeljet më të mëdha janë konstatuar në ndermarjen e gjelberimit, sherbimit të varezave etj.

Risku i auditimit ka qenë më i madh në këta sektorë, gjë që ka bërë që ti kushtojmë më tepër vëmendje e kohë këtyre sistemeve duke kryer auditime më të shpeshta.

**Nga auditimet konstatohet se veprimtaria ekonomike-financiare e njesive të audituara nga viti në vit ka përmirësuar të menaxhimit të fondeve, uljen e rasteve të shkeljeve, dhe një shprehje të vullnetit të njesive shpenzuese për të kryer cdo punë apo shërbim në përputhje me legjislacionin në fuqi.**

Eshtë me rëndësi të madhe që cdo njësi shpenzuese mbështetur mbi objektivat e saj të matshme e të arritshme të identifikojnë, vlerësojnë dhe të menaxhojnë riskun duke hartuar rregjistrin e riskut në zbatim të Ligjit nr 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" nëni 11, pikë 2.

Eshtë për t'u theksuar se ka probleme në zbatimin si duhet të kontrollohet të brendshëm, për shkak se ka njësi që nuk njohin kuadrin ligjor. Po kështu ka probleme në ndarjen e qarte të detyrave dhe njohjen e tyre nga menaxheret. Në këto kushte është e nevojshme që të rishikohen dhe të pershtaten kontrollet e brendshme, me qëllim që ato të ofrojnë sigurinë se objektivat e njesive do të realizohen.

### REALIZIMI I PLANIT TË INVESTIMEVE

Investimet e përfuara në bashkinë Berat ( të prokuruar nga bashkia) gjatë vitit 2016, u financuan nga:

- i. Te ardhurat e bashkise në shumën 160 545 000
- ii. Investime nga Komiteti i Zhvillimit të Rajoneve në infrastrukture në shumën 384 225 000
- iii. Investime të tjera nga Buxheti i shtetit për infrastrukturë 63 864 000 leke
- iv. Investime të tjera nga Buxheti i shtetit (Ujesjelles Roshnik) 54 779 000 leke.

Investime në proces nga viti 2015						
Nr.	Emërtimi i objektit	Planifikuar për periudhën	Vlera e prouaruar	Realizuar për periudhën	Realizimi progresiv	
					Vlera	%
1	Rik.Urb I lulishtes perend. sh. T.Muzaka (K.Shtese)	7515630	9714312	0	0	0
2	Rikualif. dhe rikonst. I haps. Urbane L. Barrikade	7382610	13310994	7352005	13280389	100
3	Rikualif dhe rikonstr. I rrugëve në L. D. Kastrioti	10000000	24828818	9999999	14354439	58
4	Supervizim i hapës. Urbane L. Barrikade	16800	16800	16800	16800	100
5	Supervizim "Rik. I rrugëve në L. Donika Kastrioti"	18000	18000	18000	18000	100
6	Supervizim "Rikonstr. I Bibliotekës V. Buharaja"	180000	180000			0
7	Supervizim Ndërtim i Kullës së Sahatit	48000	48000			0
8	Kolaudim "Rik i Cerdhës Nr. 1"	1080	1080			0
9	Supervizim "Restaurim i anës përëndimore muri i Kalasë"	2880	2880			0
10	Supervizim "Rikonstr. I Parkut Deshmoret e Kombit"	180000	180000	180000	180000	100
11	Supervizim "Rik i trot. Ura e Varur-Ura e Gorices"	115200	115200	115200	115200	100

**BASHKIA BERAT**

12	Kolaudim "Rik i trot. Ura e Varur-Ura e Gorices"	47988	47988	47988	47988	100
13	Rikonstruksion I trot. Antipatrea Bashki-Gjykate	7364466	12923310	7364000	12922844	100
14	KUZ fshati Dyshnik	101968	101968			0
15	Superv. Riparime rr. Komuna sinje 5880, 3360	9240	9240	9240	9240	100
16	Kolaudim Rik Lulishte perendimore, loti opsional	54120	54120	54120	54120	100
17	Superv. Nderhyrje emergjente varrezat Suelas Burdullias	11040	11040	11040	11040	100
18	Kolaud. Rik. I fasadave BLV Republika	3000	3000	3000	3000	100
19	Mbikq. "Rik. I lulisht. Perend loti opsional"	64800	64800	64800	64800	100
20	Kolaud. "Rik, rrug. ne L. D. Kastrioti"	38280	38280	38280	38280	100
21	Asfaltim i rruges Velabisht-Gjoroven (Det. i ish Komunes)	627166	627166	627166	627166	100
<b>Totali</b>		<b>33782268</b>	<b>62296996</b>	<b>25901638</b>	<b>41743306</b>	<b>67</b>

**Investime te parashikuara per vitin 2016**

Nr.	Emërtimi i objektit	Planifikuar për periudhen	Vlera e prokuruar	Realizuar per periudhen	Realizimi progresiv	
					Vlera	%
1	Projekti I rruges Pyjore-Uznove	2000000				0
2	Projekti "Rikonstr. I rr Antipatrea Xh e Beqarit-Sh. Harmonia fetare	3250000				0
3	Projekti"trajtimi I fasadave dhe Ndr. Rrugor nga hyrja e qytetit-Uznove	2750000				0
4	Projekte, bashkefinansim me FZHR	3750000	3750000	3750000	3750000	0
5	Kerkime dhe studime	548500	394478	394478	394478	100
6	Pajisje Aparati I Bashkise	5332000	616603	616603	616603	100
7	Automjet Aparati I Bashkise	4668000	4668000	4668000	4668000	100
8	Rikonstruksion ndertesa e Bashkise	43291728	78347107	43285463	43285463	55
9	Detyrim per bashkep. me Fondin Shqiptar te Zhvillimit	1964458	1964458	1964458	1964458	100
10	Ndertim Muri I Kalase midis 2 kullave	4000000	4964741	3979722	3979722	0
11	Rikualifikim I hapësirave urbane lagja "30 Vjetori"	2451180	2451180	865084	865084	35
12	Rik. I ures se perroit sheshi axhensia dhe largimi I aluvioneve MCR	1020000	1019377	0	0	0
13	Ujesjellesi I Paftalit	9000000	9438306			0
14	Mbrojtja e shpatit te perroit nga ujrat (Zagore Uznove)	675367	551760	551760	551760	100
15	Superv +Kolaud. Mbrojtja e shpatit te perroit nga ujrat (Zagore Uznove)	11400	11400	11400	11400	100
16	Rik. I catise se objekt. Qend.Kult."Margarita Tutulani"	2282405	2270400	2261760	2261760	100
17	Rokonstr rrugesh, trotuar dhe ndricim (bashkefinans. Me qarkun)	10426360	0	0	0	0
18	Supervizim" Rikonstr. I Bashkise se Re"	142403	673763			
19	Kredia e banesave sociale	4500000	1451711	1451711	1451711	0
20	Blerje automjete per Nd. E Sherbimeve	2994000	2994000	2994000	2994000	100
21	Blerje autokulle per Ndermarrjen e Sherbimeve	1986000	1986000	1986000	1986000	100
22	Blerje Makine autofrigoriferike per Drejtorine Arsimore	1994880	1994880	1994880	1994880	100

**BASHKIA BERAT**

23	Hidroizolim I tarraces se kopshtit "28 Nentori"	1295586	1295586	1286504	1286504	99
24	Kolaud. Superv. Hidroizolim I tarraces se kopshtit "28 Nentori"	9534	2988	2988	2988	100
25	Nderhyrje emergjente ne varrezat Suelas dhe burdullias	1431036	1431036	1416816	1416816	99
26	Supervizim "Rivit. I shetitores Republika sh. T. Muzaka" Loti 3	0	1333333			0
27	Supervizim "Rik.i ures se perroit sheshit Axhensia MCR	21600	21600			0
28	Kolaudim "Rik i trot. Ura e Varur-Ura e Gorices"	47988	47988			0
29	Kolaudim i hapës. Urbane L. Barrikade	9360	9360	9360	9360	100
30	Kolaudim "Nderhyrje emergjente varrezat Suelas Berdullias	1	1			0
31	Supervizim "Rikonstr. I haps urbane 30 Vjetori"	6000	6000			0
32	Supervizim "Skema Ujitesë Bilce"	59677	59677			0
33	Supervizim Rik Rr. Stadiumi i Vjeter-Stadiumi i Ri	0	872626			0
34	Rikonstruksion I bibliotekes "Vexhi Buharaja"Kont. Shtese	1946640	1946640	1946640	1946640	100
35	Rivit I shetit.Republ. sh. T. Muzaka, Loti 3 (pjesa e bashkise)	17294555	17294555			0
36	Ujesjellesi Uznove-Bilce	5000000	4950796			0
<b>Totali</b>		<b>136160658</b>	<b>148820350</b>	<b>75437627</b>	<b>75437627</b>	<b>51</b>
<b>Totali i Investimeve me fonde te bashkise</b>		<b>169942926</b>	<b>211117346</b>	<b>101339265</b>	<b>117180933</b>	<b>56</b>

**Investime me fonde te buxhetit te shtetit**

Nr.	Emërtimi i objektit	Planifikuar për periudhen	Vlera e prokuruar	Realizuar per periudhen	Realizimi progresiv	
					Vlera	%
1	Rikonstrks. Ujesjellesi Roshnik, Vojnik	53927384	63647384	53927139	63647139	100
2	Suprvizim Punimesh Ujesjellesi Roshnik	852000	585600	465600	585600	100
3	Ndert.Fusha sportive A.Xhindole,Xh.Cekini, 28 Nentori	106934	7424400	0	7330320	99
4	Rikonstr. I trot., parmak. Ura e Varur-Ura e Gorices	7824071	57830323	7725312	57731564	100
5	Ndertim Shkolla 9-vjecare + Kopesht Karkanjoz	83003	19929917	0	19846914	100
6	Ndertimi I Kullës se Sahatit	4035786	4035786	0	0	0
7	Rikualif. dhe rikonst. I parkut"D. e Kombit",trotuareve	14705774	81232082	14702177	81228485	100
8	Rikonstruksion I bibliotekes "Vexhi Buharaja"	12030191	34570859	10058076	34545384	100
9	Rivit I shetitores Republika sh. T. Muzaka, Loti 3	153190665	153190665	130122840	130122840	85
10	Rikonstr. I rruges Stadiumi I Vjeter-Stadiumi I Ri dhe sheshi I stadiumit	149982995	312462933	102428700	102428700	33
11	Skema Ujitesë Bilce	63864813	74325513	79970702	63864813	86
12	Rikonstruksion i rruges Antipatrea Ura e Varur -Ura e Gorices	27805479	48850889	16105889	16105889	33
13	Smart City Kioskat informuese Progr "Shqiperia dixhitale"	14650000	0			



## BASHKIA BERAT

<b>Totali</b>	<b>998237873</b>	<b>1491438389</b>	<b>719524230</b>	<b>928980447</b>	<b>62</b>
<b>Totali i Investimeve: fonde te Bashkise + buxheti i shtetit</b>	<b>1168180799</b>	<b>1702555735</b>	<b>820863495</b>	<b>1046161380</b>	<b>61</b>

Gjate vitit 2016 ne zbatim te buxhetit te miratuar me VKB si dhe fondet e akorduar nga Fonde per Zhvillimin e Rajoneve , jane realizuar procedurat e prokurimit elektronik sipas legjislacionit ne fuqi.

1. Pune civile 486 ,220 969 leke Pa tvsh ( fonde te investimeve ).
  2. Furnizime 9 261 829 lek pa tvsh (furnizime me ushqime, kopshte, cerdhe, konvikte
  3. Furnizime (karburant). 13 836 019 leke patvsh.
  4. Sherbime publike 15 768 311 leke pa tvsh (pastrimi i njesive admin istrative, m irembajtje e varrezave publike dhe te deshmoreve).
  5. Sherbime te mjeteve te transportit. 1277 670 leke pa tvsh.
  6. Blerje automjete dhe mjete pune 7500 000 leke Pa tvsh.
  7. Sherbim katering per qendrat PAK 5649083 pa tvsh .
  8. Materiale per mirembajtje te zakonshme 5100 000 leke pa tvsh.
- a. Investimet nga **burime te veta** per vitin 2015 u planifikuan ne shumen 123,356,000 leke, ose 22.5% e buxhetit ne total , shifer kjo e konsideruesheme ne raport me vitin 2014, dhe ne fakt u realizua 60,000,000 leke.
- b. Investimet nga **burime te veta** per vitin 2016 u planifikuan ne shumen 160 545,000 leke, ose 23.8% e total buxhetit te vet bashkise.



PLAN BUXHETI I VITIT 2017

1. Informacion i permblodhur plan buxhetit te vitit 2017 .

Buxheti i vitit 2017 vlerësohet si:

- ✓ buxheti i reformave
- ✓ i konsolidimit fiskal,
- ✓ i rritjes së pagave dhe pensioneve

Në vitin 2017 rritja ekonomike do të arrijë nivelin e 3.8%, ndërsa për tre vitet e ardhshme do arrijë një nivel mesatar mbi 4%.

Investimet publike në vitin 2017 do të luajnë gjithashtu një rol të rëndësishëm, pasi ato janë planifikuar në një nivel relativisht të lartë, nivel i cili shkon në 5% të Prodhimit të Brendshëm Bruto .

Përgjatë më shumë se dy dekadave të fundit deficioni i përgjithshëm fiskal në buxhetin e vitit 2017 është 2%, dhe konsiderohet si niveli më i ulët historik . Zhvillimi i qëndrueshëm dhe afatgjatë i vendit ka qenë dhe **mbetet një prioritet konstant i punës së Qeverisë.**

**Projektbuxheti i vitit 2017 parashikon:**

- – Të ardhura publike 27.3% të Prodhimit të Brendshëm Bruto.
- – Shpenzime publike 29.3% të Prodhimit të Brendshëm Bruto. (Ky parashikim nënkupton një rritje prej 6.5% ndaj nivelit të pritur të shpenzimeve për vitin 2016)
- – Një deficit buxhetor 2% të PBB-së.
- Një reduktim të borxhit publik, nga niveli i pritur prej 71.8% i Prodhimit të Brendshëm Bruto në fund të vitit 2016 në 69.1% të Prodhimit të Brendshëm Bruto në fund të vitit 2017. **Ky parashikim respekton një kërkesë të Ligjit Organik të Buxhetit .**

**Reforma administrative territoriale e cila ka vetëm një vit që ka filluar zbatimin e saj i ka dhënë efektet e veta në 61 Bashkitë e reja .**

- Buxheti i pushtetit vendor i vitit **2017 do të jetë 3.1% e PBB-së** duke mbështetur zbatimin e Reformës administrative territoriale.
- **Transferata e pakushtëzuar do të jetë rreth 20 % më e lartë se e vitit 2016**, dhe do të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e investimeve dhe shërbimeve publike në favor të qytetarëve. Në buxhetin e vitit 2017 një mbështetje të konsiderueshme gjejnë funksionet e transferuara në vitin 2016, për të cilat do t'u alokohen rreth 7 miliardë lekë.
- Këto funksione janë të lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me shërbimet publike vendore dhe me mundësitë për zhvillimin e qëndrueshëm në nivel vendor.



## BASHKIA BERAT

- Për vitin 2017, për këto funksione është parashikuar edhe fondi i **nevojshëm për rritjen e pagave**. Zbatimi i Reformës territoriale filloi në buxhetin e vitit 2016 me financimin e funksioneve të reja të transferuar në njësitë e vetëqeverisjes vendore.
- Në funksion të zbatimit të reformës administrativo-territoriale buxheti vendor i vitit 2017, do të shoqërohet me një model të ndryshimit të financimit dhe menaxhimit financiar në qeverisjen vendore. Arritjet kryesore të kësaj reforme të shoqëruara me efekte pozitive në buxhetin vendor, do të jenë në drejtim të: Rritjes në tërësi të buxhetit për pushtetin vendor, nga 2.1 për qind të PBB-së që zinte para reformës në 3.1 për qind të PBB-së në projektbuxhetin e vitit 2017.

Në bazë të këtyre reformave **krijimi i detyrimeve të reja të prapambetura është vënë nën kontroll**.

Buxheti 2017 do të synojë një deficit të përgjithshëm **2% të PBB** dhe balancë primare pozitive, me mbështetje për sektorët kryesorë të rritjes ekonomike dhe balancë primare pozitive.

Qeveria mbetet e angazhuar për të përmirësuar performancën e financave publike; për rigjallërimin e ekonomisë dhe për të vazhduar implementimin e reformave strukturore.

Sigurisht kemi sfida të rëndësishme përpara në një vit elektorale dhe të reformës të sistemit të drejtësisë, por ky program bashkëpunimi e ka vendosur ekonominë e vendit mbi themele të shëndetshme që garantojnë vazhdimin e rrugës në drejtim pozitiv.

### Struktura financiare e buxhetit 2017

Ne zbatim të Ligjit nr. 9836 date 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Udhezimit të Ministrit të Financave nr. 4 date 29.02.2016 "Për përgatitjen e buxhetit vendor", Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë nr. 250 date 23.03.2016 u ngrit **Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS)** si dhe **Ekipet e Menaxhimit të Programeve të Shpenzimeve**.

Përgatitja e Dokumentit është mbështetur në dokumentat baze :

- Strategjia e Zhvillimit për Teritorin e Bashkisë Berat (hartuar me mbështetjen teknike të projektit PLGP të Agjensisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Nderkombëtar dhe Co-Plan )
  - Strategjia dhe Plani i Veprimit i Turizmit për periudhën 2011 – 2021.
  - Strategjite Sektoriale që janë të lidhura me kopetencat e pushtetit vendor.
  - Plani i shpenzimeve për mirmbajtje të infrastrukturës në ujtime të kullimit.
  - Plani i shpenzimeve për Pyllzime të reja, sisteme malore, trajtime silvikulturore .

Plan buxheti i **vitet 2017 është i balancuar**. Në mbështetje të Udhezimit të Ministrit të Financave nr.2 date 06.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" buxheti vendor është unik, të ardhurat dhe shpenzimet parashikohet për çdo të tyre, pavarësisht nga burimet e financimit. Struktura e tij është e plotë, për të gjithë elementet, si në krahun e të ardhurave dhe në atë të shpenzimeve.

Mbështetur në përvojën e viteve të mëparshme, ky buxhet është i detajuar deri në llogaritë analitike, për çdo të ardhurë dhe shpenzim.

### Buxheti 2017 ka këtë strukturë sipas natyrës së shpenzimit:

1. Pagat parashikohen të zënë 33.7% të buxhetit të vetë (pa transferimet specifike).



## BASHKIA BERAT

2. Sigurimet shoqerore 5.3 %.
3. Shpenzimet operative dhe te mirembajtjes 35 %.
4. Shpenzimet per investine kapitale 25.8 %.

### **Buxheti 2017 ka kete structure sipas programeve buxhetore te financuar nga burime te veta:**

Programi : Planifikim, Menaxhim, Administrim 33.6 % Funkcionet administrative te bashkise.

Programi : Sherbime Publike 29.5 %

Programi: Zhvillimi i Kultures,Turizmit, Rinise dhe sportet 9.4%

Programi: Arsimi, parauniversitar dhe cerdhe 9.4 %

Programi: Planifikimi i territorit , investimeve dhe kontrollit te projekteve . 17.9%.

### **A. PLANI I TË ARDHURAVE**

#### **a. Te ardhurat lokale**

Pranë Bashkisë Berat në kuadër të hartimit të planit të të ardhurave, pjesë përbërëse e Buxhetit të vitit 2017, është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik.

Si çdo vit planifikimi i të ardhurave të vitit 2017 është kryer në mënyrë analitike, duke ju referuar cdo takse dhe tarife vendore, të cilat analizohen në hollësi. Cdo e ardhur është planifikuar në bashkëpunim me punonjësit të cilët kanë lidhje të drejtpërdrejtë në punën e tyre me arkëtimet nga taksat dhe tarifatat vendore. Këtu bën pjesë gjithë stafi i Drejtorisë së Taksave Regjistrimit të Biznesit dhe Tregjeve, stafi njësisive administrative Roshnik, Sinjë, Otlak, Velabisht ashtu edhe stafi i Drejtorive të tjera të Bashkisë Berat.

Viti 2017 është viti i dyte që planifikojmë të ardhurat e Bashkisë “së madhe” Berat në të cilën përfshihet një territor më i gjërë. Natyrisht që një planifikim i tillë paraqet akoma shumë vështirësi kjo për faktin se 4 njësitë administrative kanë burime financiare tepër të kufizuara.

Gjithashtu paraqet shumë vështirësi mbulimi i shpenzimeve të këtyre njësive me të ardhurat që ato vetë do realizojnë. Si rrjedhojë shpenzimet e tyre do mbulohen nga të ardhurat që do sigurojë Bashkia Qëndër.

Planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore për vitin 2017 mbështetet kryesisht në :

- Reflektimin e politikave fiskale të aplikuara gjatë vitit 2016, me ndryshimet përkatëse.
- Ruajtjen e qëndrueshmërisë të nivelit të të ardhurave nga taksat e tarifatat vendore duke forcuar kapacitetet administruese dhe duke rritur numrin e taksapaguesve.
- Realizimin faktik të ardhurave të vitit 2016.
- Parashikimin e të ardhurave nga agjentët tatimorë,
- Thellimin e vazhdueshëm të punës në drejtim të evidentimit dhe regjistrimit të subjekteve te paregjistruar në organet tatimore.

Për vitin 2017 të ardhurat totale pashikohen në shumën 549,580,000 leke. Këto të ardhura përbëhen nga të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore, të ardhurat nga legalizimet si dhe të ardhurat nga transferata e pakushtëzuar sipas tabelës se mëposhtme :

Emertimi	I pritshmi 2016	Plan 2017
Të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore	285,548,000	430 427 000



## BASHKIA BERAT

<b>TOTALI</b>		285,548,000	430 427,000

### RISITË DHE RISQET QË PRITEN TË NA SHOQËROJNË GJATË VITIT TË ARDHSHËM 2017 TË CILAT DO TË NDIKOJNË TË ARDHURAT E BASHKISË

#### RISITË :

- Në vazhdimësi ,permiresimi i shërbimit ndaj tatimpaguesve si rrjedhojë e shtrirjes në njësitë administrative dhe zyrat e taksave ku paguhen taksat e familjes te sistemit bashkëkohor informatik tatimor TAIS per administrimin e taksave dhe tarifave vendore. Kjo do të sjellë uljen e kohës së shërbimit ndaj tatimpaguesve dhe ulje të punës manuale të specialistëve.
- Në kuadër të reformës teritoriale zgjerimi i vijës administrative të Bashkisë do të rrisë potencialin e të ardhurave të Bashkisë Berat, duke shfrytëzuar rritjen e bazes se taksueshme,dhe evidentimin e metodave te reja.
- Shtohet lehtësirat tatimore per biznesin dhe konkretisht:
  - Për Bizneset e hapura, nga familjet e reja,dhe te drejtuara nga gra, në vitin e parë të ushtrimit të aktivitetit ,për të gjitha Njësitë Administrative ,kjo tarifë do të paguhet ne 20% me ulët te tarifës normale.
  - Për Familjet me një prind ,me fëmijë deri në moshën 22 vjec,që janë në vazhdimësi të arsimimit, per të gjitha Njësitë Administrative ,kjo tarifë do të paguhet në 30% me ulët të tarifës normale.
- U ndryshua Tarifa e Pastrimit dhe largimit te mbeturinave Per subjektet e biznesit te madh, që nxjerrin gurin ranor,etj,dhe perpunimin e tyre,per cdo njësi administrative,qe do te sjelle ndryshim ne te ardhura.
- U shtua Tarifa e shërbimit per kryerjen e procedures se kalimit te pronësisë te pasurive te paluajtshme,të ndërtuara deri më 10.08.1991, e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedon akte fitimi pronësie, si dhe për regjistrimin e tyre .
- Për familjet në nevojë tarifa e shërbimit për kryerjen e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.08.1991, e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedon akte fitimi pronësie , kjo tarifë do të paguhet ne 50% me ulët te tarifës normale.

Në total, për vitin 2017, të ardhurat nga taksat dhe tarifave vendore janë planifikuar në shumën 430,415,000 lekë. Kundrejt realizimit të pritshëm të vitit 2016 në shumën 285,548,000 lekë të ardhurat e vitit 2017 janë planifikuar +144,867,000 lekë ose +34% më shumë.

Bashkia Qëndër planifikon të arkëtojë 246,544,000 lekë ose 57 % kundrejt planit total të të ardhurave të bashkisë.

Njësia administrative Roshnik planifikon të arkëtojë 9,434,000 lekë ose 2 % kundrejt planit total të të ardhurave të bashkisë.

Njësia administrative Sinjë planifikon të arkëtojë 10,097,000 lekë ose 2 % kundrejt planit total të të ardhurave të bashkisë.

Njësia administrative Otlak planifikon të arkëtojë 32,231,000 lekë ose 8 % kundrejt planit total të të ardhurave të bashkisë.



## BASHKIA BERAT

Njësia administrative Velabisht planifikon të arkëtojë 19,582,000 lekë ose 5 % kundrejt planit total të të ardhurave të bashkisë.

Nga agjentët tatimore planifikohen të arkëtohen 183,871,000 lekë ose 26 % kundrejt planit total të të ardhurave të bashkisë.

Tabela e mëposhtme paraqet një informacion mbi planifikimin e të ardhurave të vitit 2017 sipas grupeve kryesore :

Emërtimi	Plani 2017	Në /000 lekë
		Struktura (në %)
Të ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin per biznesin e vogel	10,143	2
Të ardhura nga taksat vendore	167,120	39
Të ardhura nga tarifat vendore	112,012	26
Të ardhura nga Drejtoria Ekonomike e Arsimit	12,400	3
Të ardhura të tjera	122,740	29
Të ardhura nga legalizimet	6,000	1
<b>TOTALI</b>	<b>430,427</b>	<b>100</b>

Peshën kryesore të rritjes së planit të të ardhurave të vitit 2017 në krahasim me realizimin e pritshëm të vitit 2016 e kanë të ardhurat nga taksat vendore në vlerën +25,795,000 lekë, rritje e cila vjen si rrjedhojë e planifikimit të ardhurave për tu realizuar nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, takse tabele dhe nga taksa mbi token bujqësore si dhe nga efektet e ndryshimeve në paketën fiskale.

Në pasqyrat e mëposhtme paraqitet analitikisht planifikimi e cdo takse dhe tarife vendore për vitin 2017.

### Pasqyra përmbledhëse e planit të të ardhurave të vitit 2017 e Bashkisë Berat

në /000  
lekë

Nr	Emertimi	Plani 2017
<b>I</b>	<b>Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin per biznesin e vogel</b>	<b>10,143</b>
<b>II</b>	<b>Taksat vendore</b>	<b>167,119</b>
1	Takse tabele	8,843
•	Tabelë për qëllime identifikimi	6664
•	Tabelë për qëllime reklamimi	2,179
2	Te ardhura nga zënia e hapsirave publike	14,533
3	Takse ndikimi ne infrastrukturë nga ndertimet e reja	30,000
4	Takse fjetje ne hotel	2,869
5	Takse mbi token bujqesore	19,206
6	Takse e mjeteve te perdorura	20,510

**BASHKIA BERAT**

7	Takse e kalimiti te drejtes se pronsise(ZRPP)	3,000
8	Takse mbi ndertesat	59,134
•	Biznes	49,990
•	Familje	9,144
9	Takse trualli	8,010
•	Biznes	7,104
•	Familje	906
10	Te tjera taksa	1,015
<b>III</b>	<b>Tarifat vendore</b>	<b>112,012</b>
1	Tarife e pastrimit	65,373
•	Biznes	41,697
•	Familje	23,676
2	Tarife e ndriçimit publik	25,576
•	Biznes	8,858
•	Familje	16,718
3	Tarife gjelberimi publik	13,366
•	Biznes	6,228
•	Familje	7,138
4	Tarife regjistrim veprimtarie biznesi	1,235
5	Tarife e sherbimit administrativ	700
6	Tarife per license /certifikate per transport rrugor	1,900
7	Tarifa per zenie salle dhe celie karteles	275
8	Tarife e sherbimit te varrimit	0
9	Tarife urbanistike	300
10	Tarife per lende drusore	1,995
11	Tarife uji i pijshem	280
12	Tarife therje	365
13	Te tjera tarifa	648
<b>IV</b>	<b>Tarifa te Drejtorise Ekonomike te Arsimit</b>	<b>12,400</b>
1	Te ardhura nga konviktet	1,200
2	Te ardhura nga cerdhet	4,000
3	Te ardhura nga kopshtet	7,200
<b>V</b>	<b>Te ardhura te tjera</b>	<b>122,740</b>
1	Te ardhura nga parkimi	1,923
2	Te ardhura nga qerate	104,685
3	Te ardhura nga gjobat, k. vonesa etj..	1,400
4	Te tjera te ardhura nga pronesia	1,000

**BASHKIA BERAT**

5	Te ardhura nga biletat	0
6	Te tjera debitore dhe gjyqe (Nga debitoret e Tokes +KLSH)	13,733
<b>VI</b>	Te ardhura nga legalizimet	<b>6,000</b>
### **PROGRAMI I MENAXHIMIT TE PRONAVE TE BASHKISE DHE REGJISTRIMI I TYRE NE Z.V.R.P.P.**

#### **Përshkrimi i programit**

Ky program ka per qellim rritjen e te ardhurave te bashkise nepermjet nje , menaxhimi sa me te mire te pronave te bashkise, si dhe rritjen e numrit te pronave te regjistruara ne Z.R.P.P.

#### **Politika e programit**

Politika e ketij program eshte permiresimi i gjendjes financiare te bashkise nepermjet rritjes se numrit te ambjenteve te dhena me qira ose kontrata te tjera si dhe monitorim sa me efikas I tyre.

#### Njesite shpenzuese

- Bashkia Berat

#### Objektivat e programit

- Menaxhimi i 304 njesive te tregut Industrial.
- Menaxhim i pronave te dhena me qira .
- Regjistrimi ne Z.R.P. P i pronave te bashkise.

#### Produkte :

- Te ardhurat nga Tregu Industrial i Lagjes “ 30 Vjetori ” per vitet 2017 , 2018, 2019 do te jenë përkatësisht 14,548,464 lekë.
- Te ardhurat nga dhena me qira e pronave

Për vitin 2017 do të jetë 3,000,000 lekë

Për vitin 2018 do të jenë 3,060,000 lekë

Per vitin 2019 do te jenë 3,121 ,200 lekë



- Regjistrimi në Z.V.R.P.P

Për vitin 2017 të 120 pronave .

Për vitin 2018 të 150 pronave.

Për vitin 2019 të 160 pronave .

- Shpenzimet e regjistrimit të pronave

Për vitin 2017 do të jenë 720,000 lekë.

Për vitin 2018 do të jenë 900,000 lekë.

Për vitin 2019 do të jenë 960,000 lekë.

## **PROGRAMI I STREHIMIT DHE MENAXHIMIT TE BANESAVE SOCIALE ME QERA**

### **Pershkrimi i programit**

Ky program ka per qellim ti vije ne ndihme familjeve ne nevoje per subvencionim e qerave per keto familje sipas nenit 24 te Ligjit nr. 9232 date 13.05.2004 “Per programet sociale per strehimin e banoreve te zonave urbane”, ndertimin e nje pallati me 24 apartamente me bashkefinansues Entin Kombetar te Banesave, duke kontribuar me truallin qe do te perdoret per ndertimin e ketij objekti, vazhdim i pjesmarrjes ne projektin “Per subvencionimin e kredive me interesa te zbutura zbatuar nga M.P.P.T.

### **Politika e programit**

Politika e ketij programi konsiston ne ardhjen ne ndihme te familjeve ne nevoje si nepermjet dhenies se bonusit te strehimit per subvencionin e qerave t e familjeve ne nevoje, pjesmarrjes ne projektin “Per subvencionimin e kredive me interesa te zbutura” zbatuar nga M.P.P.T

### **Njësitë shpenzuese**

- **Bashkia Berat**
- **Enti Kombetar i Banesave**

### **Objektivat e programit**

- Ndertimi i banesave ne ndihme te familjeve ne nevoje.
- Menaxhimi i 48 apatameneve te banesave sociale me qera.
- Perfshirja ne skeme e familjeve qe perfitojme bonus strehimi.



## BASHKIA BERAT

- Perfshirja ne skeme e familjeve të strehuara në banesat sociale qe perfitojme subvencionim te qirasë.
- Perfshirja ne skeme e familjeve qe perfitojne nga subvensioni i i kredive me interes te zbutur, projekt i zbatuar nga M.P.P.T.

### Produkte te programit :

Te ardhurat nga banesat sociale për vitin 2017 ne shumën 3,986,088 lekë

Te ardhurat nga banesat sociale për viti 2018 ne shumën 3,986,088 lekë

Te ardhurat nga banesat sociale për viti 2019 ne shumën 3,986,088 lekë

Te ardhurat nga apartamentet e Entit për vitin 2017 ne shumën 308,820 lekë

Te ardhurat nga apartamentet e Entit për viti 2018 ne shumën 314,996 lekë

Te ardhurat nga apartamentet e Entit viti 2019 ne shumën 321,296 lekë

Shpenzimet e mirëmbajtjes për vitin 2017 do te jenë 250,000 lekë

Shpenzimet e mirëmbajtjes për vitin 2018 do te jenë 300,000 lekë

Shpenzimet e mirëmbajtjes për vitin 2019 do te jenë 350,000 lekë .

Shlyerja e kestit te kredise për vitet 2017 ,2018, 2019 do te jete per cdo vit ne në vlerën 58,770 € nga të cilat 31,770 € do te shlyhet nga fondet e bashkise dhe 27,000 € do te shlyhen nga fondi i banesave sociale.

Përfshirja në skeme për bonus strehimi për familjet e pastreha me ta ardhura familjare mujore shume te uleta do te jete :

Per vitin 2017 ne vleren 200,000 leke .

Per vitin 2018 ne vleren 204,000 leke .

Per vitin 2019 ne vleren 208,080 leke .

Perfshirja ne skeme e familjeve të strehuara në banesat sociale qe perfitojme subvencionim te qirasë.

Per vitin 2017 ne vleren 1,200,000 leke .

Per vitin 2018 ne vleren 1,224,000 leke .

Per vitin 2019 ne vleren 1,248,480 leke .

### Pastrimi

Programi Strategjik O5P4: Identifikimi dhe adresimi i nevojave për ndërhyrje rehabilituese të kopshteve, shkollave 9-vjeçare dhe të mesme në njësitë administrative të Bashkisë Berat.



## BASHKIA BERAT

Projektet:

- 1.Rikonstrukcion i shkollës 9 vjeçare në fshatin Veternik, Velabisht.
- 2.Rikonstrukcion i shkollës së mesme të bashkuar Starovë, Velabisht.
- 3.Rikonstrukcion i shkollës së mesme dhe ndërtimi i ambjenteve sportive në fshatin Sinjë, Sinjë.

### **PROGRAMI I ZHVILLIMIT TE KULTURES, TURIZMIT DHE SPORTIT**

**Përshkrimi i programit.** Programi në thelbin e tij ka zhvillimin e jetës kulturore artistike dhe sportive të qytetit, ti jape hapësirë identifikimit, promovimit, mbrojtjes së aseteve kulturore dhe turistike që Bashkia Berat zotëron. Aktivitetet Kulturore të mbështetura në vlerat e jashtëzakonshme të trashëgimisë kanë një rritje në numër dhe në cilësi nga viti në vit.

Jeta artistike dhe kulturore e qytetit jo vetëm duke u mbështetur në rivitalizimin e metejshëm të projekteve ekzistuese, të cilat janë kthyer tashmë në një traditë për qytetin e Beratit por synon hapjen dhe mbështetjen e hapësirave të reja për projekte të tjera inovative të cilat vijnë dhe nga persona të tretë, shoqëria civile apo ente të tjera kombëtare e nderkombëtare.

#### **Paqyre e e shpenzimeve për Qendren Kulturore “Margarita Tutulani”, në 000/lek**

Nr.	Emertimi	Fakt 2015	I pritshëm 2016	Plan 2017	Plan 2018	Plan 2019
1	Paga	11,996	13,943	14,652	14,945	15,244
2	Sigurime	2,002	1,375	2,330	2,377	2,424
3	Shpenzime operative	6,727	5,929	7,300	7,446	7,595
4	Investime			500	800	1,200
Totali		20,725	21,247	24,782	25,568	26,463

**Prishmeria e realizimit të shpenzimeve është në masën 102.5% kundrejt faktit 2015 .**

**Parashikimi i shpenzimeve në vitin 2017 është në masën 16.6 më shumë se prishmeria e vitit 2016.**

#### **Drejtoria Kulturës, Turizmit dhe Sportit Bashkia Berat**

Luan një rol të rëndësishëm dhe objektivat kryesor janë:

- a) Zhvillimi i jetës kulturore artistike dhe sportive të qytetit.
- b) Promovimi i aseteve kulturore dhe turistike që Bashkia Berat zotëron .



## BASHKIA BERAT

- c) Hartimi i projekteve me partnerë ndërkombëtarë
- d) Identifikimi, promovimi, mbrojtja e trashëgimisë kulturore.
- e) Ndërgjegjësimi në zhvillimin kulturor dhe social i komunitetit duke u bazuar në trashëgiminë kulturore.
- f) Zbatimi i politkave për zhvillimin e turizmit dhe Strategjisë së Turizmit e cila i permbahet Planit të Veprimit për vitet 2011-2021
- g) Koordinimi me institucionet kulturore dhe shoqërinë civile për organizimin e eventeve kulturore.
- h) Rregullimi i veprimtarisë me jashtë administratës së Bashkisë

- Në aspektin e turizmit

Është bërë implementimi i strategjisë dhe plan veprimit të turizmit për zbatimin e qytetit të Beratit. Plotësimi i një pakete promovionale përfshirë website, harta turistike, fletëpalosje me materiale për atraksionet, akomodimin, restorantet, materiali në dy gjuhë shqip dhe anglisht. Zhvillimi i aktiviteteve për një turizëm vjetor dhe koordinimi me bizneset turistike për rritjen e shërbimit.

- Në aspektin e bashkëpunimeve me Organizata dhe Partnerë Ndërkombëtarë

Është kryer korrespondenca me Ministrinë e Punëve të Jashtme për çdo takim dhe vizitë të zhvilluar dhe raportimi zyrtar përkatës. Është punuar intensivisht për të aplikuar për çdo thirrje për projekte nga partnerët e huaj dhe do vazhdojmë me intensitet kontaktet dhe bashkëpunimin me :

- ❖ Bashkitë Binjake
- ❖ Rrjetet Ndërkombëtare
- ❖ Organizatat dhe donatorë
- ❖ Projektet e Bashkimit European.

Gjithashtu është ndjekur axhenda e përfaqësuesvë të huaj pranë Bashkisë Berat

- Në aspektin e Sporteve

Mbas një maratone të gjatë dhe shumë të vështirë ekipi i Tomorit arriti të jetë në kategorinë e parë të kampionatit të futbollit por fitoj edhe kupën e Shqipërisë për kategorinë e Dytë. Edhe tek shumesportesh Tomori për traditë, fal punës pasionante dhe shumë profesionale nga trajneret, kemi ekipe dhe sportiste që radhiten ndër me të mirët. Vecanerisht kemi rezultate në sportet e Gjimnastikës, Pingpongut, Mundjes. Pozitivisht paraqiten edhe sportet e Peshengritjes, Boksit. Protagonistët e tyre kanë qenë shumica të rinj e të reja, pa neglizhuar moshat e tjera, paresore në synimet e drejtorisë dhe të institucioneve kulturore e sportive kanë qenë dhe do të jenë edhe në të ardhmen angazhimet rinise.



Nr.	Emertimi	Fakt 2015	I pritshem 2016	Plan 2017	Plan 2018	Plan 2019
1	Paga	1,019	1,115	1,246	1,271	1,296
2	Sigurime	167	109	198	202	206
3	Shpenzime operative	2,750	3,421	3,300	3,366	3,433
Totali		3,936	4,645	4,744	4,839	4,936

- Në aspektin e ruajtjes dhe promovimit të Trashëgimisë e arti

Për vitin 2016, Trashëgimia ka fituar edhe një rol më të madh në politikat e Bashkisë Berat. Trashëgimia Kulturore është tipari më dallues i Beratit, ajo është simboli identifikues i Bashkisë Berat dhe luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin kulturor dhe ekonomik të tij. Asetet e trashëgimisë ushqejnë industrinë e turizmit dhe atë të kulturës.

Risi

1. Për herë të parë këtë vit është organizuar eventi Hapja e sezonit Turistik në të cilin u organizua për të parën herë Panairi 2-ditor Ballkanik i Artizanatit.
2. Për herë të parë këtë vit u rikthye tradita e gurskalitësve të qytetit përmes së Organizimit të Kampit Ndërkombëtar Gurskalitësit e Beratit.
3. Festivali Rajonal Folk Art në Ditën Kombëtare të Trashëgimisë.

### **Projekte 1.Krijimi i Shtegut Interpretues së Goricës**

Në bashkëpunim me Kompaninë SICALA dhe vullnetarin Camille Saillant dhe me ndihmën e Ambasadorëve të Natyrës pranë Qendrës Rinore Berat kemi krijuar shtegun turistik të Kalasë së Goricës. Përgjatë shtegut të kalasë së Goricës janë vendosur panele me informacion në dy gjuhë si dhe stola dhe kosha mbeturinash për një eksperiencë sa më të kënaqshme. Krijimi i shtegut është bërë në përputhje me vlerat mjedisore dhe të trashëgimisë në rrënojat e Kalasë së Goricës, duke përdorur materiale të përshtatshme. Shtegu do t'i ofrojë vizitorëve informacion për natyrën, trashëgiminë, florën dhe faunën e zonës, si dhe një ecje të dobishme për një shëndet të mirë fizik.



## 2. Restaurimi i Murit ndërmjet Kullave 1 dhe 2 në Lagjen Kala

Projekti i restaurimit është hartuar nga specialistë të DRKK-Berat. Financimi për zbatimin e tij u bë i mundur nga Bashkia Berat. Restaurimi është duke u kryer në murin ndërmjet kullave 1 dhe 2. Ky segment muri ishte i dëmtuar prej një kohe të gjatë dhe paraqiste rrezik potencial për turistët dhe ndaj vlerave të trashëgimisë universale të Beratit

## 3. Krijimi i Qendrës së Interpretimit Turistik

Projekt nga stafi i Bashkisë Berat vlersuar me çmimin e parë “Risi Turistike” në Konkursin “Risi Turistike” të organizuar në Berat nga Risi Albania. Sot kjo zyrë ofron një akses shumë të mirë për turistët duke u vendosur në qendër të qytetit. Në projektin e zyrës janë krijuar panele që ilustrojnë vlera të cilat përshkruhen si vlera të jashtëzakonshme universale në deklaratën e rëndësisë së UNESCO-s i cili justifikon hyrjen e Beratit në Listën e UNESCO.

### Produktet të tjera të Krijuara në Zyrën e Informacionit Turistik

- Aplikacioni Visit Berat
- Krijimi i Sallës Multimediale
- Tabela Shpjeguese dhe Orientuese
- Katalogu i Artizanatit Berat
- Ekspozitori i Produkteve
- Stendat e Promovimit
- Kioska e Promovimit

## 4. Zhvillimi i Sektorit të Artizanatit

**Panaire** – Ky zhvillim ka konsistuar kryesisht në ndihmesën që bashkia ka dhënë për organizimin e sektorit të artizanatit, promovimit të sektorit si dhe rritjen e mundësive për zhvillim ekonomik përmes Panairit Rajonal të Artizanatit si dhe tregut i Artizanatit gjatë gjithë sezonit të verës

**Krijimi i Suvenireve** -Bashkia ka marrë pjesë në projektin për krijimin e suvenireve duke dhënë komente dhe ekspertizë për krijimi e tyre. Projekti është zbatuar nga ARG dhe financuar nga Risi Albania

**Krijimi i Shoqatës Margarita** -Stafi i Bashkisë Berat ka ndihmuar krijimin e të parës shoqatë artizanati në qytetin e Beratit: Qendra e Artizanatit Margarita e cila ndodhet ne ambjentet e Pallatit te Kulturës



## BASHKIA BERAT

### ➤ Nxitje eventeve kulturore dhe kordinimi tyre

Nr.	Data	aktiviteti
1	21- Shkurt	"Dita Ndërkombëtare e Guidave Turistike".
2	5- mars	Certifikimi i Guidave Turistike
3	18 - Maj	Dita e Hapjes së Sezonit Turistik
4	2-3Qershor	Hapja e sezonit turistik malor .Aktivitet i zhvilluar ne date në qafe dardhe ne vendin e quajtur "Cesma e Nënë Tarikos
5	23-29 Qershor	Festa e Miqsise
6	8-24 Korrik	Fundjavat ne Berat
7	21-23 Korrik	Festivali Multi Kulturor
8	12 –Korrik	Portokalli
9	22-Korrik	Certifikimi kampit gurskalitesve
10	4- Gusht	Maratona Këngës Popullore
11	9-10 Shtator	Një fundjave ne Berat
12	11- Shtator	Event shenjterimi Nene Terezes
13	27-Shtator	Dita Turizmit
14	29-Shtator	Folk Art 2016
15	28-Nentor	Ekspozita e Firmetareve te Beratit



### Njësia Shpenzuese

- Qendra Kulturore “Margarita Tutulani”
- Bashkia Berat
- Donator

#### Qendra Kulturore “Margarita Tutulani”

Ka funksionuar edhe per vitin 2016 si nje njesi shpenzuese duke pasur ne perberje funksionimin e Qendres Kulturore “Margarita Tutulani”, Bibliotekes “Vehxhi Buharaja” ,Galerise se Arteve “E.Lear” si dhe Klubin e shumesporteve “Tomorri”, me nje presonel prej 24 punonjesish .

#### Pasqyra nr. 18

**Realizimi i shpenzimeve per Qendren Kulturore “Margarita Tutulani”** në 000/lek

**Qendra kulturore “M. Tutulani”** luan një rol të rëndësishem ne zhvillimin e aktiviteteve kulturore,sportive si dhe promovimin ne aktivitete kombetare dhe nderkombetare te vlerave artistike, kulturore e sportive qe ka qyteti i Beratit.Funksionon si njesi shpenzuse e Bashkise Berat dhe ne varesine e saj jane biblioteka “Vehxhi Buharja”, galeria “E.Lear”,klubi shume sportesh “Tomori”

**Qendra Kulturore** me gjithë aktivitete e saj si Qender, te Bibliotekes “V.Buharaja” Galerise se Arteve “Edwart Lear” , te Klubi i shumesporteve “Tomorri”, mbylli vitin buxhetor 2016 pa detyrime.

Aktivitetet e zhvilluara per vitin 2016 jepen ne tabelat e meposhteme:

#### Pasqyra nr. 19

##### Aktivitete te zhvilluara ne Qendren Kulturore “Margarita Tutulani”

Nr.	Data	aktiviteti
1	4- Mars	Komedi standap “ Po ti kush je ”
2	7-mars	Dita e mesuesit
3	14-Mars	ardhja e pranveres “Dita e veres”
4	11-Mars	Konkurrim i grupit te kenges qytetare ne Elbasan
5	30- Prill	Koncert ne Diten Boterore te Jazz-it
6	27- Maj	Aktivitet kulturor artistik kushtuar tre koloseve te kultures dhe mendimit filozofik shqipetar Abdyl,Naim e Sami Frasheri
7	31-Maj	Java e filmit Rus
8	1-Qeshor	Dita e Fëmijeve

**BASHKIA BERAT**

9	5- Qeshor	'Pasdite argetuse'
10	9-Qershor	Koncert vocal -instrumental
11	8- Korrik	Berati në UNESCO Grupi kenges qytetare concert ne 8-vjetorin e Beratit ne UNESCO
12	9-10 Korrik	Triptik Kulturor 'hapat festiv'
13	28- Korrik	"Të rinjtë dhe Kënga Qytetare Beratase"
14	17 - Gusht	Koncert te Kengetarit Zviceran MARIO ZAPPA
15	19- Tetor	"Nata e Firzamonikes"
16	Nentor	Teatri kukullave "Shtepia e Patave"
17	22-Nentor	Aktivitet "Une mbroj te drejtat e femijeve"
18	29-Nentor	Koncert orchestra simfonike
Parashikohet gjate muajit dhjetor		
19	Dhjetor	" Show Rinor "
20	Dhjetor	Koncert I Grupi Karakteristik I kenges qytetare sheshi Teodor Muzaka
21	Dhjetor	Orkestra Frymore sheshi T.Muzaka
22	Dhjetor	Teatri Kukullave sheshi Teodor Muzaka
23	Dhjetor	Koncert Festiv i Fund Vitit Gezuar 2015

**Pasqyra nr. 20****Aktivite te zhvilluara ne Galerine Edwart Lear**

Nr.	Data	Ekspozitat
1	23 - Prill	Ekspozita Edmond Kojani
2	11 - Maj	Ekspozita "RETRO TIME"
3	1-Qershor	Ekspozita "COLOR 2016 "
4	25-Qershor	Ekspozita kolektive "ART DURRES 16"
5	2- Korrik	Ekspozita "Fëmijët e Qeshur"
6	30- Shtator	Ekspozita shkolla artistike "Ajet Xhindole"
7	6- Tetor	Ekspozita autorve Shpresa Milaqi Bajko&Ilir Dosari
8	23 -korrik	Ekspozita Retrospektive e autorit Arben Golemi
9	28 -Nentor	Ekspozite e Firmetareve te Beratit
Parashikohen ne muajin Dhjetor		
10	23- Dhjetor	Ekspozita e Ikonografisë
11	26-Dhjetor	Cmimi vitit "Lear 2015"

**Biblioteka "V.Buharaja"**

Ka funksionuar per vitin 2016 si strukture brenda Qendres Kulturore "Margarita Tutulani", me mision mirembajtjen e fondit te bibliotekes dhe shtimin e numrit te lexuesve per te gjithë grupmoshat, duke synuar shtimin e fondit te materialeve te bibliotekes, zhvillimin e aktivitetve promovuese e nxitese ne funksion te shtimit te lexuesve e kryesisht atyre te rinj ne funksion te promovimit kultures dhe edukimit.



## Pasqyra nr. 21

## Aktivitete te zhvilluara ne Biblioteken "Vexhi Buharaja"

Nr.	Data	Aktiviteti
1	18- Shkurt	Promovimi i librit me rrefenja "Udhetim pas portes se territ" Rezlind Pilaft
2	21- Mars	Dita Nderkombetare e Poezis
3	22 -Prill	Promovimi i librit "Stina e Hijeve" shkrimtarit Virion Graci
4	17-Qershor	Promovimi i librit "Gruaja e Shiut" shkrimtari Bashkim Hoxha
5	21-Korrik	Promovimi i librit me poezi "Ushtrime te melankolisë" shkrimtari Prec Zogaj
6	22-Korrik	Promovohet romani "E premtë Mbasdite" shkrimtare Brunilda Zllami
7	23-Shtator	Promovimi i novelës " Zemer" shkrimtari Nasho Jorgaqi
8	3-Tetor	Ore e hapur ne gjimnazin 'Kristaq Capo'
9	13-Tetor	Promovimi "Gjerdani i arte i brezave te muzikës Banda Frymore" autori Stavri Bobo
10	9-Dhjetor	Promovimi librit "Udhëkryqë Shqiptare-Gjermane" Paskal Milo

**Klubi i shumespoteve "Tomorri".**

**Pershkrimi i programit.** Masivizimin dhe konsolidimin e sistemit sportiv në dobi të shëndetit të shoqërisë sonë që nga fëmijët e kopshteve, të rinjtë, studentët dhe të rriturit.

Edhe per vitin 2016 ka funksionuar si strukture brenda Qendres Kulturore "Margarita Tutulani", me mision nxitjen, zhvillimin dhe përhapjen e kulturës sportive në qytet, nëpërmjet organizimit të projekteve sportive dhe pjesëmarrjes ne aktivitete kombetare dhe nderkombetare.

**Objektivi:** Rritja e cilësisë sportive te të rinjve pjesëmarrës në ekipe të llojeve të ndryshme të sportit, si ping pongut, bilardos, basketbollit, gjimnastikes, mundjes, boksit, karates, peshengritjes, futbollit të ngritura pranë klubit te Shumsportit.

Arritja e sukseseve kombëtare dhe ndërkombëtare të ekipit ping pongut, mundjes, karates, boksit dhesporteve te tjera, me gjithë financa te kufizuara ky klub ka arritje e suksese kombëtare dhe ndërkombëtare.

Gupi Karakteristik i Këngës Qytetare Berati në konkurimin e Festivalit Folklorik Tipologjik Kombetare i Këngës Popullore Qytetare zhvilluar në Elbasan në datat 11-12 Mars 2016 ku Grupi i Këngës Qytetare Berati u vlersua nga juria me cmimin "Mustafa Budini" dhe si "Performanca & Debutusi" më i mirë i kënges qytetare u vlersua këngëtari Petrit Berisha.



**Klubi i shumespoteve “Tomorri”** realizoi aktivitetet.

### **Ekipi i Ping pong-ut**

Kampionati kombetar U15 27-28- Shkoder 26.05.2016  
Kampionati kombetar ekipor U21 Durres 26.05.2016  
Kampionati kombetar ekipor te Ritur Shkoder 26.05.2016  
Kampionati kombetar U15 27-28- Shkoder 07.06.2016  
Kampionati kombetar ekipor U21 Durres 07.06.2016  
Kampionati kombetar te Ritur Femra meshkuj korc 11.10.2016  
Kampionati kombetar U12date Permet 11.10.2016

### **Ekipi i Mundjes**

10.06.2016 kampionati greko-romak tirane

### **Ekipi i Boks-it**

1.06.2016 kampionati ekipor vlore

### **1.06.2017 Ekipi i peshngritjes**

10.06.2016 kampionati kupa e shqiperise

### **Ekipi i Gjimmastikes**

1. Kampionati Kombëtar për para të Rinj të Rinj dhete Rritur Më datë 29 Maj
2. Kupa e Republikës. Tiranë 3 tetor..

### **Ekipi i Karates**

1. “Elbasani Open” Elbasan dhjetor 2016

### **Ekipi Pjatelit**

1. Kampionati Lokal

### **Gjysëm maratona e Beratit**

“Gjysmë-Maratona e Beratit” u zhvillua në datën 26 Maj.

**Qendra Kulturore** me gjithë aktivitete e saj si Qender, te Bibliotekes “V.Buharaja” Galerise se Arteve “Edwart Lear” , te Klubi i shumesporteve “Tomorri”, mbylli vitin buxhetor 2015 pa detyrime.

**BASHKIA BERAT****Projekte Vitin 2017** (të dhënat në 000/leke)

Projekte-Propozime për vitin 2017			
Drejtoria e Kulturës, Turizmit dhe Sporteve			
Prioriteti	Projekti		Lekë
1	Kampi i Gurskalitësve të Beratit	Bashkia Berat Donator	113
2	Dixhitalizimi i Trashëgimisë Kulturore (Materiale të Lëvizshme)	Bashkia Berat Donator	1.000
3	Krijimi i Tregut të Artizanatit	Bashkia Berat Donator	3.000
4	Restaurimi i Sterës së Ujit (Qendra e Interpretimit të Trashëgimisë)	Bashkia Berat Donator	12.000
5	Krijimi i Qendrës Komunitare Kala për Zhvillim	Bashkia Berat Donator	445
6	Dokumentimi i Trashëgimisë Kulturore Shpirtërore	Bashkia Berat Donator	107
7	Krijimi i Suvenireve Karakteristike për Qytetin e Beratit	Bashkia Berat Donator	315
8	Rehabilitimi Mjedisor i Lagjes Mangalem	Bashkia Berat Donator	800
9	Zhvillimi i Qendrës për Nxitjen e Artizanatit	Bashkia Berat Donator	510
10	Trashëgimia Botërore në Sistemin e Informacionit Gjeografik (GIS)	Bashkia Berat Donator	150
	<b>Totali</b>		<b>18.440</b>

**BASHKIA BERAT**

Drejtoria e Kultures Turizmit dhe Sportit Aktivitetet për Vitin 2017 (të dhënat në 000/leke)

Numri	Aktivitete	Data	Lekë
1	Çmimi për Restaurimin më të mirë (18 Prill – Dita e Monumenteve dhe Siteve)	18 prill	75
2	Ditët e Turizmit Kulturor dhe Natyror (përfshirë Paketën turistike 2017)	6-7 Maj	750
3	Dita e Hyrjes së Beratit në UNESCO	8 Korrik	120
4	Dita e Gatimeve Tradicionale	26 Dhjetor	100
5	Dita turizmit festa Roshnikut	27 Shtator	100
6	Panairi ullirit muaji tetor	tetor	100
7	Cesma tarikos	qershor	100
	<b>Totali</b>		<b>1345</b>

Lista e projekteve të Qëndres Kulturore “Margarita Tutulani” për vitin 2017(të dhënat në 000/leke)

Nr	Emertimi I aktiviteteve	Vlera
<b>I</b>	<b>Konkurime</b>	
1	Teatri I kukullave Froni I mbretit (pershtatur per kukulla)	<b>70</b>
2	Play and dance 2017 QKF	<b>20</b>
3	Konkurrim kënge dhe ansambël	<b>80</b>
<b>II</b>	<b>Koncerte festive</b>	
4	Koncert festiv 14-Marsi	<b>40</b>
5	Festivali i 45-te I këngës për fëmije QKF	<b>250</b>
6	Fundjavat ne Berat “hapat festiv” 11 Korrik – 27 Gusht	<b>600</b>
7	Koncerti fund vitit për fëmije QKF	<b>40</b>
8	Java artistike e fund vitit 2017	<b>350</b>
<b>III</b>	<b>Evenimente</b>	

**BASHKIA BERAT**

9	27-Marsi Dita Ndërkombetare e Teatrit 1 HOOP FESTIVAL (Festival Teatri)	500
10	29- Prill Dita Ndërkombetare vallzimit	60
11	30-Prill Dita Ndrëkombetare Jazz	40
12	21-Qershori Dita Ndërkombetare e Muzikes	30
13	29- Shtatori dita Kombëtare e Trashëgimisë Kulturore Festivali "Folk Art"	200
<b>IV</b>	<b>Te tjera</b>	
14	“Show Rinor” projekt	40
15	Karnevale e Beratit 25 Shkurt	200
16	Teater Komedi me student të arteve	40
17	Harmoni Brezash	100
18	Teater “ Perendia ju ndjefte”	190
19	Vere dhe portokalle “ Portokalli ”	1000
20	Maratona e Këngës popullore	1000
21	Festivali multi kulturor Berat 2017	500
	Totali	5340

**Lista e projektevetëGalerisë së Arteve “Edward Lear” përvitin 2017 (tedhenat ne 000/leke)**

Nr	Emertimi i aktiviteteve	Vlera
1	Ekspozita “Lear 2017” Çmimi I vitit “Lear 2016”	40
2	Kolor 2017 1 Qershor Kolor	90
3	Ekspozite Kolektive “ Hapsire 2017”	28
4	Ekspozite personale Miradije Ramiqi	15
5	Ekspozite Caush Vathi dhe Jordan Findiku	14

**BASHKIA BERAT**

6	Ekspozite Agron Mulliqi	20
7	Kolonia e artisteve te vegjel	45
8	Ekspozit vjetore me artist Beratas	1000
	<b>Totali</b>	<b>1252</b>

**Lista e projekteve të Bibliotekes “Vexhi Buharaja” për vitin 2017 (të dhënat në 000/leke)**

Nr.	Emertimi i aktiviteteve	Vlera
1	22-Mars Dita Ndërkombetare e Poezise	13
2	21-Prill Dita Ndërkombetare e Librit	13
3	2-Maj Dita Ndërkombetare e Librit për fëmijë	13
	<b>Totali</b>	<b>39</b>

**Lista e projekteve të Klubit të Shumësporteve “Tomorri” për vitin 2016 (Të dhënat në 000/lekë)**

Nr.	Emertimi i aktivitetit kombëtar	Vlera
1	Aktiviteti i ekipit I Gjymnastikës	60
2	Aktiviteti i ekipit i Boks-it	130
3	Aktiviteti i ekipit i Ping –Pongut	215
4	Aktiviteti i ekipit I Mundjes	110
5	Aktiviteti i ekipit I Peshngritjes	100
6	Aktiviteti i ekipit I Basketboll-it	100
7	Aktiviteti i Maratonës së Beratit 2017	100
8	Aktiviteti i ekipit I Karatesë	30
	<b>Totali</b>	<b>845</b>



## KF TOMORRI 1923 sh.a.

KF TOMORRI 1923 sh.a. është financuar nga bashkia në masën 100% të nivelit të planifikuar, financuar në shumën 30 000 000 leke, kundrejt 30 000 000 leke të planifikuara, në vitin 2016,

. I gjithë fondi është konsumuar në bazë të planit financiar të sh.a, ku pjesën më të madhe të buxhetit e përben zeri paga dhe sigurime shoqërore të totalit të shpenzimeve, 11% e zënë shpenzimet e trajtimit ushqimor dhe të djetave të sportistëve, pjesën tjetër prej 29 % të totalit të shpenzimeve e përbejnë shpenzime të tjera operative, si faza përgatitore, uniforma, shpenzime për ilaçe etj.,

Perdorimi i fondeve konform legjislacionit e në përputhje me **statusin** e tij, mbetet një nga sfidat e rëndësishme të funksionimit të KF TOMORRI 1923. Sh. A.

Ekipi i Futbollit “FK Tomori 1923” SHA pas kryerjes së një analize Financiare rezultoi me një detyrë prej **13.232.288** leke kundrejt subjekteve të ndryshme, ku pjesën më të madhe të kësaj detyre e zë OSHEE, Ujesjelles Kanalizime dhe Drejtoria Rajonale Tatimeve Berat. Me Drejtorin Tatimore Berat, FK Tomori 1923 SHA prej kohësh ka lidhur një akt-marrveshje të cilën pritet ta mbyllë të gjithë detyrën në fund të vitit 2016. Përsa i përket detyrimeve ndaj OSHEE të cilat përbejnë një problem të madh për Financat e “FK Tomori 1923” SHA jemi në negociatë për të lidhur një akt-marrveshje. Për pjesën tjetër të Detyrës ndaj subjekteve të ndryshme

Me poshtë po ju paraqesim me hollësi të gjithë detyrimet ndaj subjekteve përkatës :

- ❖ Detyrime për Tatime e sigurime për vitin 2012-2016 , shuma 565 509 leke
- ❖ Detyrime ndaj O.S.Sh.E., shuma 9 800 000 leke ( 2010-2015)
- ❖ Ujesjelles kanalizime, shuma 1 300 000 leke, -
- ❖ Detyrime Hotelerie , shuma 150 000 leke
- ❖ Detyrime furnituesh, shuma 1 417 000 leke.

**Keto detyrime do të përfshihen në plan buxhetin e vitit 2017.**

## PROGRAMI I MIRMBAJTJES SE INFRASTRUKTURES NE UJITJE DHE KULLIM

### Pershkrimi i Programit

Programi i Mirëmbajtjes së kanaleve ujitje dhe kulluse parashikon mirëmbajtjen e vazhdueshme të kanaleve kryesore, kanaleve të dyta me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve për komunitetin. Sistemet e ujitjes dhe të kullimit funksionojnë për të nxitur dhe mbrojtur interesat e të gjithë përfituesve.

Sistemet e ujitjes dhe të kullimit funksionojnë edhe për të parandaluar erozionin dhe ndotjen, si dhe për të nxitur mbrojtjen e mjedisit.

**BASHKIA BERAT****Politika e Programit**

Politika e këtij programi konsiston në ofrimin e një infrastrukture sipas standardeve bashkëkohore në të gjithë komponentët e saj, të shtrirë në të gjithë territorin e Bashkise Berat, me qëllim që t'iu mundësojë fermerve ujitjen dhe kullim normal në cdo parcele toke , krijimin e kushteve infrastrukturore dhe organizative për një mirëmbajtje të vazhduar të sistemit te kanaleve ujitse dhe kulluse.

**Objektivat dhe programet e Qellimit:****Ujitja dhe Kullimi**

Program 4240

(000)

Nr.	Emertimi	Fakt 2015	I pritshem 2016	Plan 2017	Plan 2018	Plan 2019
1	Paga		1,091	2,430	2,479	2,528
2	Sigurime		175	386	394	402
3	Shpenzime operative		1,701	10,280	10,486	10,695
4	Investime				-	-
5						
Totali		-	2,967	13,096	13,358	13,625

**Administrimi i pyjeve**

Program 4260

(000)

Nr.	Emertimi	Fakt 2015	I pritshem 2016	Plan 2017	Plan 2018	Plan 2019
1	Paga		1,686	2,242	2,287	2,333
2	Sigurime		283	356	363	370
3	Shpenzime operative		57	400	408	416
4	Investime				-	-
5						
Totali		-	2,026	2,998	3,058	3,119



1. *Përmirësimi i kushteve ne sistemin e kanaleve ujëse.*

- Reabilitimi i kanalit ujites Gjeroven-Starove
- Reabilitimi i kanalit ujites Starove-Remanic
- Reabilitimi i kanalit ujites Duhanas
- Reabilitimi i kanalit ujites Ullinjas
- Reabilitimi i kanalit ujites Mbolan
- Reabilitimi i kanalit ujites Lapardha 2
- Reabilitimi i kanalit ujites Lapardha 1
- Reabilitimi i kanalit ujites Morave
- Reabilitimi i kanalit ujites Otlak
- Reabilitimi i kanalit ujites Uznove

2. *Përmirësimi i kushteve ne sistemin e kanaleve Kulluse.*

- Pastrimi i kanaleve kulluse ne fushen e Staroves.
- Pastrimi i kanaleve kulluse ne fushen e Lapardhas.
- Pastrimi i kanaleve kulluse ne Morave.
- Pastrimi i kanaleve kulluse ne Otlak
- Pastrimi i kanaleve kulluse ne Dushnik.
- Pastrimi i kanaleve kulluse ne Orizaj.
- Pastrimi i kanaleve kulluse ne Uznove.

3. *Përmirësimi i kushteve ne burimet ujore “Rezervuaret”*

- Mirmbajtja e saraqineskes ne rezervuarin e Mjeshoves.
- Zhbllokimi i pusetes se shkarkimit ne rezervuarin e Roshnikut.
- Zhbllokimi i pusetes se shkarkimit ne rezervuarin e Uznoves.
- Zhbllokimi dhe reabilitimi I shkarkuesit katastrofik ne rezervuari e Mbolanit.
- Reabilitimi I shkarkuesit katastrofik ne pjesen fundore te rezervuarit Ullinjas.



Më konkretisht projektet e programuara për tu mirmbajtur për vitet 2017, 2018 dhe 2019 ne Kullim dhe Ujitje janë :

- Objektet ne kullim.

Nr	Emri i kanalit kullues (sipas inventarit, kollona <b>B</b> )	Kanal te I (pare) ne km	Kanal i II (dyte) ne km	Volumi kanale I (pare) ne m3	Volumi kanale II (dyte) ne m3	Vlera e shpenzimit ne leke	Siperfaqja qe i permiresohet
							kullimi nga kjo mirembajtje
							ne ha
1	KK Orizaj		5		9,700	688,312	300
2	Dyshnik Stream (Parangoi)	1	5	3,000	8,000	780,560	200
3	KK Lapardha		5		10,000	709,600	400
4	KK Morave		4		7,500	532,200	100
5	KK Gjolet		2		4,500	319,320	50
6	Starove Field		2		5,000	354,800	250
7	KK-Uznove		2		4,000	283,840	100
					<b>Shuma</b>	<b>3,668,632</b>	

Objektet ne ujitje.

Emri i objektit/Skemes	Kanal te I	Kanal i II	Volumi	Volumi	Volumi I pastrimit me mjet+krah m3	Vlera e	Vlera e
	(pare)	(dyte)	kanale I	kanale II		shpenzimit	shpenzimit
	gjithsej	gjithsej	(pare)	(dyte)		ne leke	ne leke
	ne km	ne km	gjithsej	gjithsej		Pastrime me	Pastrime me

**BASHKIA BERAT**

			ne m <sup>3</sup>	ne m <sup>3</sup>		mjet	krah
KU Orizaj		6.2		4650.00	1000+3650	141,920	2,638,950
Starove÷Reamnice	7.00		8,000		8000+0	567,680	
Balte e kuqe+dega e Perondis		3		3000.00	3000+0	212,880	
KU Gjeroven-Starove	7.20		1,000		0+1000		723,000
Ullinjas	4.00		900		0+900		650,700
KU Morave		1.5		1500.00	1000+500	70,960	361,500
KU Lapardha 2		4.5		3400.00	1500+1900	106,440	1,373,700
<b>Shuma</b>						<b>1,099,880</b>	<b>5,747,850</b>
<b>Shuma Totale</b>						<b>6,847,730</b>	

❖ **Projektet e programuara për investime per tu realizuar për vitet 2017, 2018 dhe 2019 janë :**

## 1.Kanali ujites Ullinjas

## Kanali Ujites BRU-27 Ullinjas

Nr	NR. ANALIZ E	EMERTIMI I PUNIMIT	NJESIA	SASIA	CMIMI	VLEFTA
1	3,44/1	Germim dheu kanalesh sek. detyruar me krahe	m <sup>3</sup>	917.00	723.00	662,991.00
2	2,426/3	Prishje shtrese betoni veshje kanali	m <sup>3</sup>	835.00	3,509.00	2,930,015.00
3	3,59/a	Germim dheu themel muri mbajtes	m <sup>3</sup>	3.30	637.00	2,102.10
4	3.243	Beton per mure e themele mbajtes C16/20	m <sup>3</sup>	7.30	11,010.00	80,373.00
5	3.243	Veshje kanali me beton C16/20 t=8cm	m <sup>3</sup>	835.00	11,010.00	9,193,350.00
6	An.	Ndertim Prize 40*50cm e re	cope	3.00	53,598.70	160,796.10



## BASHKIA BERAT

7	An.	Ndertim tombino Betoni ø500mm L=5m	cope	3.00	92,085.50	276,256.50
8	An.	Ndertim Ure kembesore HD=1m B=2m	cope	2.00	11,508.15	23,016.30
9	3.243	Beton per HD Tombinosh ekzistuese	m3	5.10	11,010.00	56,151.00
10	4.70	F.V. Tub Celiku ø324mm L=12ml	ton	0.53	167,073.00	88,548.69
11	2.20	Lyerje me bitum e katrama e tubit te celikut	m2	12.10	696.00	8,421.60
12	2,37/5	Transport materialesh me auto deri 5 km	m3	1,200.00	319.00	382,800.00
		<b>Shuma</b>				<b>13,864,821.29</b>
		<b>TVSH 20%</b>				<b>2,772,964.26</b>
		<b>Shuma pergjithshme</b>				<b>16,637,785.55</b>

Projekti ndodhet ne Qendra Transferimit Teknologjive Bujqesore (Fush Kruje) dhe ne Ministrine e Bujqesise

#### **4. PROGRAMI I PLANIFIKIMIT TE MBROJTJES DHE SHTIMIN E SIPERFAQES PYJORE**

Realizimi i ketij programi ne kete sektor ka nje ndikim ne rritjen e turizmit ,eliminimin e erozionit, rritjen e fiqis punetore, krijimin e nje mjedisi sa me te paster, uljen e ndotjeve te ajrit etj. Pyllzime te reja, sistemime malore, trajtime silvikulturore ne Njesite Administrative Velabisht, Otlak, Roshnik, Sinje.

**Qellimi.** Menaxhimin e qendrueshem dhe afat gjate te pyjeve dhe kullotave , shtimin e te ardhurave ne buxhetin lokal nga shfrytezimi i burimeve natyrore .

Programi Strategjik O2P7: Hartimi dhe zbatimi i planit afatmesem per menaxhimin e pyjeve dhe kullotave lokale.

Projektet:

1.Hartimi i planit afatmesëm për manaxhimin e pyjeve dhe kullotave



2.Sistemimi i parkut me pisha në faqen lindore të kalasë.

### **Objektivat**

1. Hartimi i projekteve të reja në pyllëzime ,sherbime kulturore ,sistemime malore në ndertime pritash, lerash dhe reabilitimin e rrugeve pyjore.
2. Ngritja e struktureve për masat parandaluese kundër zjarreve.

### **Detyrat**

1 .Zbatimi i monitoriumit në pyje me ndalim të veprimtarisë së shfrytëzimit të lëndës drusore në fondin puçor ( përjashtim etëm për nevojat e komunitetit për dru zjarri).

2. Parandalimin e hapjes së sipërfaqeve pyjore me qëllim ndryshim destinacioni( ulishte, vreshta etj).

## **IV.PROGRAMI I SHERBIMEVE VETERINAR**

I. **Qëllimi** : Mbrojtja e shëndetit publik nga sëmundjet Zoonoz të transmetueshme nga konsumimi i produkteve të nënprodukteve shtazore si dhe kontakti me kafshët e gjalla

### **2. Objektivat Buxhetore Afatmesme**

1. Mbrojtja e shëndetit publik nga sëmundjet Zoonoz të transmetueshme nga konsumimi i produkteve të nënprodukteve shtazore si dhe kontakti me kafshët e gjalla

2. Zbatimi i legjislacionit veterinar : ligji nr.10465 dt29.09.2011 “ për shërbimin veterinar’

3. Mbrojtja nën kontroll e situatës epidemiologjike për sëmundjet .

4. Sensibilizimi i publikut nëpërmjet medias së shkruar dhe elektronike.

### **3. Detyrat e sektorit të veterinarisë.**

1. Kontroll dhe marrje masash në zbatim të legjislacionit veterinar.



2. Eleminimi i tregtimit të pa ligjshëm në qytetin e Beratit të produkteve dhe nënprodukteve shtazore, kafshe të gjalla, peshku, etj në bashkpunim me policinë bashkiake dhe specialist të mjedisit dhe AKU-se.
3. Kontroll dhe marrje masash administrative në njësitë e tregtimit të mishit për mungesë dokumentacioni dhe kushte higjieno-sanitare.

## 5. PROGRAMI I SEKTORIT TË BUJQËSISË

Ky sektor është i fokusuar në zbatimin e VKM 994 DT 09.12.2015 “Për procedurat e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi.” Ky realizim vjen si rezultat i bashkpunimit me ZVRPP dhe prefekturën.

### Objektivi Strategjik 4:

Zhvillimi i sektorit të bujqësisë dhe blegtorisë në funksion të zhvillimit rural dhe uljes së papunësisë.

### Programet strategjik 4 .

Programi Strategjik O4P1: Rehabilitimi i rrjetit kullues dhe vaditës në territorin e Bashkisë Berat si dhe bashkërendimi i punës me institucionet qendrore për sistemin e ujërave të larta të stuhive .

Projektet

- 1.Rehabilitimi i stacionit të elektropompave
- 2.Rehabilitimi i gjithë rrjetit ujitës, dega kryesore dhe rrjeti kanaleve të dyta.
- 3.Mbrojtja nga gërryerjet e Lumit Osum
- 4.Inventarizimi i infrastrukturës ekzistuese
- 5.Mirëmbajtja e infrastrukturës ekzistuese
- 6.Mbrojtja nga permbytjet në zone Rehabilitimi i argjinatës mbrojtëse

Programi Strategjik O4P2: Zbatimi i instrumenteve të menaxhimit të tokës në mbrojtje të tokës bujqësore nga zhvillimet urbane.

Projektet

- 1.Projekt pilot për aplikimin e instrumenteve të menaxhimit të tokës për mbrojtjen e tokave bujqësore, në një nga njësitë strukturore të përcaktuara nga PPV-ja
- 2.Replikimi i modelit të hartuar në projektin pilot në njësi të ngjashme strukturore



## BASHKIA BERAT

Programi Strategjik O4P3: Nxitja e zhvillimeve të strukturave në funksion të bujqësisë (magazinë, stalla, pika grumbullimi, kooperativa bujqësore) përmes PPV dhe rritjes së kapaciteteve të fermerëve.

Projektet

- 1.Mbyllja e procesit të inventarizimit dhe hartimit të pronave publike, subjekt transferimi në Bashki.
- 2.Përfundimi i procesit të transferimit dhe regjistrimit të pronave publike, subjekt transferimi në Bashki
- 3.Hartimi i projekteve pilot PPP për rehabilitimin e disa asetëve publike dhe kthimin e tyre në pika magazinimi bujqësore
- 4.Ndërtimi i tregjeve dhe pikave për grumbullimin dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blektorale në zonat e përshtatshme

Programi Strategjik O4P4:Mbarreshtimi i territoreve bujqësore dhe kullotave në funksion të fuqizimit të zinxhirit të prodhimit në bujqësi e blegtori.

Projektet

- 1.Hartimi i politikave për kultivimin e tokave bujqësore dhe kullotave nëpërmjet subvencioneve.

**PROGRAMI I MBROJTJES NGA ZJARRI. (funksion i deleguar , transferta specifike ).**

Nr.	Emertimi	Fakt 2015	I pritshem 2016	Plan 2017	Plan 2018	Plan 2019
1	Paga		20,646	21,297	21,723	22,157
2	Sigurime		3,194	3,571	3,642	3,715
3	Shpenzime operative		2,000	2,365	2,412	2,461
Totali		-	25,840	27,233	27,778	28,333

### TEPRICA NETO OPERATIVE E VITIT 2017 .

Ne vitin 2017 planifikohet një tepricë neto operative prej 181 260 000 leke, cila do të shtohet edhe me të ardhurat që do të trashëgohen nga viti 2016 në vitin 2017, pas rakordimit përfundimtar në degën e thesarit.

Shpërndarja e **tepricës neto operative të vitit 2017** merr parasysh:

Detyrimet e vitit 2016 si dhe programin për vitin 2017 .



## BASHKIA BERAT

1. Likujdimin perfundimtare te detyrimeve financiare per prokurimet e kryera me vlere te plote ne vitin 2016 dhe te likujduara pjeserisht, ne vitin 2016.
2. Procedura ne proces nga viti 2016 .
3. Investime te programuara per tu realizuar ne vitin 2017 .
4. Persa i perket shpenzimeve per shpronësime per interes public kemi parashikuar ne kete plan buxhet. Kompensimin financiar te shpronësimit per zgjerimin e varrezave burdullias.

### **Procedura ne proces nga viti 2016.**

2. Mirembajtje e varrezave publike dhe varrezave te deshmoreve, dekorit dhe lapidareve te Bashkise Berat eshte nje procedure (Kerkese per Propozim) e ndare ne 3 (tre) lote e cila eshte hedhur ne sistemin elektronik ne daten 03.11.2016 dhe data e zhvillimit te tenderit ka qene edhe data e fundit e pranimit te ofertave 14.11.2016. Fondi limit per kete procedure eshte 3 486 073 (tre milion katerqind tetedhjet e gjashte mije e shtatedhjet e tre) leke pa tvsh. Pas vleresimit te ofertave nga KVO shpalli fitues per lotin :Loti 1: Mirembajtja e varrezave publike dhe e varrezave te deshmoreve . **Kontrata u lidh me operatorin ekonomik fitues Brenda afateve ligjore.**  
Ndersa per **Lotin 2 Dekorit i qytetit dhe Loti 3 Mirembajtja e lapidareve** u anuluan per shkak te mos **paraqitjes se asnje operatori ekonomik ne sistemin elektronik.**  
Keta te fundit u rihodhen ne sistemin elektronik dhe pas perfundimit te afateve u anulua serishte per te njejten arsye.
3. **Ujesjellsia Prokopi-Paftal** . Njesia Administrative Sinje eshte nje procedure (Kerkese per Propozim) e cila eshte hedhur ne sistemin elektronik ne daten 20.10.2016 dhe data e zhvillimit te tenderit ka qene edhe data e fundit e pranimit te ofertave 31.11.2016. Fondi limit 7 889 891 (shtate milion e teteqind tetedhjet e nente mijë e teteqind e nentedhjet e nje) lekë pa tvsh vlere e polte dhe 7,486,651.06 (shtatemilion e katerqind e teteqind e gjashte mije e teteqind e nentedhjet) e nje leke pa tvsh vlere pjesore per vitin 2016. Pas vleresimit te ofertave nga KVO u shpall fitues. **Jemi ne pritje te lidhjes se kontrates me operatorin fitues.**
4. **Sherbimi I Konsulences** eshte nje procedure e cila eshte zhvilluar me objekt “Per hartimin e projektit te zbatimit per objektet” e ndare ne tre lote:

**Loit 1-** Rikonstruksion i rruges Antipatre-segmenti nga Xhamia e Beqarit – Sheshi i Bashkejeteses Ftare(Axhensia) dhe fasadave te ndertesave ne te dyja anet e saj”,

**Loti 2-** Trajtimi i fasadave dhe sistemi i ndricimit rrugor nga hyrja e qytetit deri ne Uznove”

**Loti 3-** Rikualifikim dhe rikonstruksion i rruges Pyjore-Uznove (vazhdim i rruges “Santa Lucia Filippine”). Fondi limit **6 666 666** (gjashte milion e gjashteqind e gjashtedhjet e gjashtemije e gjashteqind e gjashtedhjet e gjashte). Pas vleresimit te ofertave nga KVO Loti 1 dhe loti 2 u anuluan per arsye se ne sistemin elektronik ishin paraqitur operator ekonomik te cilet kishin mangesi ne dokumentacion. Persa I perket Lotit 3 eshte eshte kualifikuar per ne fazen e dyte vetem operatori ekonomik Arkon Studio dhe per kete arsye **u anulua** pasi ne fazen e dyte duhet te kualifikohen minimalisht dy operator.



5. Ndertimi i linjes se furnizimit me uje Uznove-Bilce per ujsjellesin e fshatit Bilc eshte nje procedure (Kerkese per Propozim) e cila eshte hedhur ne sistemin elektronik ne daten 02.11.2016 dhe data e zhvillimit te tenderit ka qene edhe data e fundit e pranimit te ofertave 11.11.2016. Fondi limit 4 166 666 (Kater milion e nje qind e gjashtedhjet e gjashte mije e gjashteqind e gjashtedhjet e gjashte) lekë pa tvsh. Pas vleresimit te ofertave nga KVO u shpall fituesi. **Kontrata eshte lidhur ne date 07.12.2016**
6. Blerje mjet transportues **Rimorkiator procedure** (Kerkese per Propozim) e cila eshte hedhur ne sistemin elektronik ne daten 10.11.2016 dhe data e zhvillimit te tenderit ka qene edhe data e fundit e pranimit te ofertave 21.11.2016. Fondi limit **901'724** (Nenteqinde e nje mije e shtateqinde e njezete e kater ) leke pa tvsh. Kjo procedure u anulua ( per here te dyte) pasi ne sistemin elektronik nuk ishte shpallur asnje operator ekonomik.
7. Blerje materialesh ndertimi per Ndermarjen e Sherbimeve Publike eshte nje procedure (Kerkese per Propozim) e cila eshte hedhur ne sistemin elektronik ne daten 18.11.2016 dhe data e zhvillimit te tenderit eshte edhe data e fundit e pranimit te ofertave 28.11.2016. Fondi limit 1 738 940 (nje million e shteteqind e tridhjet e tete mij e nenteqind e dyzete) lekë pa TVSh.
8. Blerje pajisje elektronike per administraten e Bashkise eshte nje procedure (Kerkese per Propozim) e cila eshte hedhur ne sistemin elektronik ne daten 21.11.2016 dhe data e zhvillimit te tenderit eshte edhe data e fundit e pranimit te ofertave 30.11.2016. Fondi limit 3 115 000 (tre milione e njeqinte e pesembedhjete mije ) leke pa TVSh. **Shpallja e fituesit:**
9. Shtesa e **kontrates se Karburantit** eshte kryer per Ndermarjen e Sherbimeve Publike dhe per Ndermarjen e Gjelberimit. Fondit Limit eshte 652 596 (gjashteqind e pesedhjet e dy mij e peseqind e nentendhjet e gjashte). **Kontrata eshte lidhur me date 24.11.2016.**
10. “Blerje lendesh djegese ( dru zjarri) per cerdhet, kopshtet, dhe shkollat e Bashkise Berat” eshte nje procedure (Kerkese per Propozim) e cila eshte hedhur ne sistemin elektronik ne daten 06.12.2016 dhe data e zhvillimit te tenderit eshte edhe data e fundit e pranimit te ofertave 19.12.2016.



BASHKIA BERAT

Perdorimi i teprices neto operative per vitin 2017

Nr.	Emërtimi i objektit	Vlera	Progr.	Shuma Sipas Programit
1	Pajisje aparati	2,086,000	1110	52,000,000
2	Rikonstruksion ndertesa e Bashkise	49,914,000		
3	Hartim Projektesh	5,000,000	4530	101,620,286
4	Restaurimi murit rrethues te kalase midi kullave	981,175		
